



RAPORT VJETOR

**MBI VEPRIMTARINË
E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**
për vitin 2015

**RAPORT VJETOR
MBI VEPRIMTARINË
E KUVENDIT TË SHQIPËRISË
për vitin 2015**

Tiranë, 2016



PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
Kapitulli 1	
Veprimtaria ligjvënëse	5
Kapitulli 2	
Kontrolli parlamentar	12
Kapitulli 3	
Funksioni zgjedhës	19
Kapitulli 4	
Veprimtaria e organeve të Kuvendit	21
Kapitulli 5	
Veprimtaria ndërkombëtare	23
Kapitulli 6	
Transparenca parlamentare	28
Kapitulli 7	
Administrimi	35
Përfundime	44



Hyrje

Bazuar në prioritetet e përcaktuara në “Planin e veprimit” të tij, në zbatim të rekomandimeve të raportit të progresit të Komisionit European për vitin 2014, Kuvendi i Shqipërisë ka intensifikuar veprimtarinë ligjvënëse, duke shqyrtuar e miratuar ligje për realizimin e reformave të rëndësishme në dobi të zhvillimit të vendit.


Në ushtrim të funksionit të kontrollit parlamentar, ka monitoruar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit Shqipëri–Bashkimi European nëpërmjet instrumenteve të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit, si dhe institucioneve të pavarura.

Përpjekje të rëndësishme janë bërë gjithashtu për rritjen e transparencës parlamentare, qasjen e publikut në vendimmarrje, nxitjen dhe promovimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, si dhe për forcimin e kapaciteteve administrative të institucionit.

Raporti vjetor i Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2015 synon të japë një panoramë analitike të punës së kryer gjatë kësaj periudhe përmes 7 kapitujve përbërës, të hartuar nga shërbimet e Kuvendit të Shqipërisë sipas specifikave dhe fushës që mbulojnë.

Kapitulli 1

VEPRIMTARIA LIGJVËNËSE





Gjatë vitit 2015 Kuvendi i Shqipërisë e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në dy sesione parlamentare: janar–korrik dhe shtator–dhjetor.

Veprimtaria parlamentare në seancë plenare është zhvilluar gjatë 44 seancave plenare në një shtrirje kohore prej 352 orësh.

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar 282 akte. Nga këto: 155 ligje, 110 vendime dhe 17 rezoluta.

Janë zhvilluar 1488 diskutime në 270 orë debat parlamentar.

Nga këto: shumica parlamentare ka zhvilluar 753 diskutime në 137 orë, kurse pakica parlamentare ka zhvilluar 735 diskutime në 144 orë.




Gjatë vitit 2015 në Kuvend janë depozituar 185 nisma ligjvënëse: 158 nga Këshilli i Ministrave dhe 27 nga deputetët.

Funksioni ligjvënës ka konsistuar në miratimin e 155 ligjeve, 64 prej tyre janë ratifikime marrëveshjesh ndërkombëtare dhe aderime në konventa të ndryshme, 2 janë ratifikime për akte normative me fuqinë e ligjit. 94 për qind e nismave ligjvënëse kanë qenë nisma të Këshillit të Ministrave, ndërsa 6 për qind nisma të deputetëve.

E përkthyer në shifra: në 155 ligje të miratuara 9 prej tyre kanë qenë nisma deputetësh dhe 146 nisma të Këshillit të Ministrave.

Katër nisma rezultojnë të jenë tërhequr nga nismëtari, ndërkohë nisma të tjera vijojnë të jenë ende në procedurë parlamentare.



Ligje të kthyera për rishqyrtim

Gjatë vitit 2015 Presidenti i Republikës ka ushtruar të drejtën e vetos për kthimin edhe një herë në Kuvend për rishqyrtim të 6 ligjeve. Kuvendi ka rrëzuar me vendim dekretet e Presidentit për ligjet e mëposhtme:

- Vendim nr. 7/2015 “Për rrëzimin e dekretit nr. 8851, datë 19.12.2014 të Presidentit të Republikës «Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 154/2014 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit’»”.
- Vendim nr. 8/2015 “Për rrëzimin e dekretit nr. 8894, datë 09.01.2015 të Presidentit të Republikës «Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 177/2014 ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë’», i ndryshuar”.
- Vendim nr. 31/2015 “Për rrëzimin e dekretit nr. 8899, datë 16.01.2015 të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 181/2014 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 ‘Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë’»”.
- Vendim nr. 60/2015 “Për rrëzimin e dekretit nr. 9043, datë 10.04.2015 të Presidentit të Republikës «Për kthimin e ligjit nr. 23/2015 ‘Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë’»”.
- Vendim nr. 84/2015 “Për rrëzimin e dekretit nr. 9206, datë 14.08.2015 të Presidentit të Republikës «Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 80/2015 ‘Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë’»”.
- Vendim nr. 85/2015 “Për rrëzimin e dekretit nr. 9205, datë 07.08.2015 të Presidentit të Republikës «Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 93/2015 ‘Për turizmin’»”.

Ligje të shqyrtuara me procedurë të përshpejtuar

Kuvendi ka ushtruar procedurën e përshpejtuar në shqyrtimin e 10 projektligjeve. Në 9 raste me kërkesë të Këshillit të Ministrave dhe në 1 rast me kërkesë të një grupi deputetësh si më poshtë:

- projektligji “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”;
- projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 48/2014 «Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare»”;



- projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit European për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II)”;

- projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 «Për kthimin dhe kompensimin e pronës», i ndryshuar”;

- projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 «Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje», i ndryshuar”;

- projektligji “Për miratimin e përjashtimeve nga taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti i kushtëzuar sipas marrëveshjes së garancisë në lidhje me marrëveshjen e huas për financimin e zbatimit të projektit për ndërtimin e rrjeteve numerike (digjitale) DVB-T2 të transmetuesit publik (RTSH)”;

- projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 «Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar”;

- projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 74/2015 «Për miratimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive ‘S2 Albania’, sh.p.k. dhe ‘Rapiscan systems’, INC ‘Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve’ dhe ‘Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013’, si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit»”;

- projektligji “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”;

- projektligji “Për ratifikimin e dokumenteve ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes, dhe qeverisë së Republikës së Italisë, përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, për realizimin e programit «Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës», nënshkruar më 12.07.2006”.

Akte normative me fuqinë e ligjit të miratuara nga Kuvendi

Gjatë vitit 2015 në Kuvend janë depozituar 4 akte normative me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave dhe, bazuar në nenin 101 të Kushtetutës, janë miratuar nga Kuvendi brenda 45 ditëve. Dy prej tyre janë depozituar në dhjetor 2015 dhe Kuvendi do t’i miratojë në janar 2016. Aktet normative të miratuara janë:

- ligji nr. 2/2015 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 2, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave «Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013 ‘Për buxhetin e vitit 2014’», i ndryshuar”;

- ligji nr. 94/2015 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 1, datë 29.07.2015, të Këshillit të Ministrave «Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014 ‘Për buxhetin e vitit 2015’»”.

Nisma ligjvënëse të tërhequra nga nismëtari

Gjatë vitit 2015 janë tërhequr nga nismëtari 4 projektligje: 2 nga Këshilli i Ministrave dhe 2 nga deputetët propozues si më poshtë:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10454, datë 21.07.2011 «Për transplantimin e indeve, të qelizave dhe të organeve në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar”. (*Paraqitur nga deputeti Vangjel Tavo.*)

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 «Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë»”. (*Paraqitur nga deputeti Taulant Balla.*)

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 «Për kuadrin



regullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura», i ndryshuar”. (Paraqitur nga Këshilli i Ministrave.)

- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 «Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar”. (Paraqitur nga Këshilli i Ministrave.)

Nisma ligjvënëse të pamiratuara (të rrëzuara në parim)

Nismat ligjvënëse të shqyrtuara nga komisionet parlamentare dhe për të cilat është propozuar mosmiratimi i tyre në seancë plenare nga Kuvendi gjatë vitit 2015 janë 4. Ato paraqiten si vijon:

- Vendim nr. 45/2015 “Për mosmiratimin e projektligjit «Për një ndryshim në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 ‘Për taksat kombëtare’, i ndryshuar»”.

- Vendim nr. 44/2015 “Për mosmiratimin e projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 «Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë»”.

- Vendim nr. 51/2015 “Për mosmiratimin e projektligjit «Për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe procesin e lustracionit»”.

- Vendim nr. 102/2015 “Për mosmiratimin e projektligjit “Për lejimin e hetimit të pavarur ndërkombëtar mbi akuzat publike të ngritura mbi çështjen «CEZ-Shpërndarje sh. a.»”

Tri nga nismat e mësipërme janë paraqitur nga deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe një nga deputetë të Grupit Parlamentar të partisë “Drejtësi, Integritet dhe Unitet”.

❖ Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar dhe miratuar 389 projektakte ligjore, konkretisht: 214 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues, ose propozimin e nismave të reja ligjore; 161 marrëveshje ndërkombëtare; 23 projektrezoluta, 9 projektvendime dhe 3 dekrete. E gjithë veprimtaria parlamentare në komisionet e përhershme dhe nënkomisionet është realizuar me organizimin e 536 mbledhjeve, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje prej 680 orë e 30 minuta.




Fig. 1. Numri i mbledhjeve të komisioneve parlamentare

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së komisioneve të përhershme dhe nënkomisioneve ka qenë edhe organizimi i 365 seancave dëgjimore: 308 për procesin legjislativ, 10 për procesin zgjedhës dhe 57 për kontrollin parlamentar.

Në përfundim të shqyrtimit të nismave ligjore komisionet e përhershme parlamentare kanë miratuar 1378 amendamente, të cilat ia kanë përcjellë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në seancë plenare.




Fig. 2. Seancat dëgjimore gjatë kontrollit parlamentar sipas komisioneve

Në mbështetje të veprimtarisë parlamentare të Kuvendit funksionojnë *Shërbimi Juridik* dhe *Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit (SHPL)*.

Shërbimi Juridik është një strukturë në komunikim të përhershëm dhe në shërbim të drejtpërdrejtë të deputetëve, organeve të Kuvendit dhe shërbimeve të tjera të administratës, me qëllim që të mbështesë evoluimin e marrëdhënieve politike-parlamentare si dhe marrëdhëniet midis Kuvendit dhe institucioneve të ndryshme me të cilat ai bashkëvepron në ushtrimin e funksioneve të tij. Në këtë kuptim, Shërbimi Juridik përpiqet të konvergojë me nevojat komplekse të Kuvendit dhe organeve të tij. Organizimi dhe drejtimi i tij funksional e fleksibël është orientuar në zbatimin e objektivave të administratës së Kuvendit dhe është bazuar në paanshmërinë dhe profesionalizmin në përmbushjen e detyrave të dhëna. Shërbimi Juridik ka realizuar përgjegjësitë dhe kompetencat e tij në përputhje me Kushtetutën, Rregulloren e Kuvendit dhe kuadrin ligjor, me qëllim përfundimin e procedurave parlamentare për miratimin e akteve (ligje, vendime, rezoluta) për seancat plenare dhe zbardhjen e akteve për t'u finalizuar me firmosjen



nga Kryetari i Kuvendit si dhe dhënie e asistencës në cilësinë e stafit mbështetës për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për komisionet hetimore, komisionet e posaçme dhe grupet e punës.

Gjatë vitit 2015 Shërbimi Juridik i ka dhënë rëndësinë e duhur funksionit të tij në dhënie e ndihmës dhe këshillimit ligjor të deputetëve në komisionet e përhershme, në nënkomisionet që funksionojnë pranë tyre, në komisionet hetimore dhe organet e tjera të Kuvendit. Objektivi kryesor ka qenë përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së mendimeve të dhëna për projektligjet, projektvendimet dhe projektrezolutat, me qëllim përmirësimin e cilësisë së legjislacionit të miratuar. Këshilltarët-juristë kanë përgatitur 235 memo për projektligjet, marrëveshjet ndërkombëtare, projektvendimet dhe projektrezolutat e shqyrtuara në komisionet e përhershme dhe nënkomisionet e ngritura pranë tyre. Rreth 70 për qind e amendamenteve të propozuara në opinionet ligjore (memot) e këshilltarëve-juristë për projektligjet janë paraqitur edhe në raportet e komisioneve të përhershme. Këshilltarët-juristë kanë përgatitur 2 memo për ligjshmërinë e ngritjes së komisioneve hetimore drejtuar Kryetarit të Kuvendit.

Këshilltarët e Shërbimit Juridik kanë intensifikuar bashkëpunimin me deputetët-anëtarë të komisioneve të përhershme për përgatitjen e relacioneve të tyre në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe të ngritjes së çështjeve problematike parimore apo të përmbajtjes nen për nen të projektligjit.

Gjatë vitit 2015 Shërbimi Juridik ka përgatitur materiale mbrojtëse, shpjegime, prapësime dhe përfaqësim (në datat kur janë zhvilluar seancat gjyqësore) të Kuvendit në Gjykatën Kushtetuese për 9 çështje. Me autorizim të Sekretares së Përgjithshme këshilltarët e Shërbimit Juridik gjatë vitit 2015 kanë përgatitur prapësime, shpjegime përfundimtare, provat, ankimimet dhe rekursat për 19 çështje në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë; 17 çështje në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë; 10 çështje në Gjykatën e Lartë.


Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit (SHPL) gjatë vitit 2015 ka mbështetur në mënyrë efektive Kuvendin me ekspertizë juridike të një standardi të lartë në çështjet e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian përmes hartimit të opinioneve ligjore dhe relacioneve për 44 projektligje, të cilat i janë propozuar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Në këto opinione Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit ka sugjeruar 79 vërejtje, nga të cilat 73 ose 92,40 për qind e tyre janë pranuar nga Komisioni për Integrimin Europian dhe komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit gjatë shqyrtimit dhe miratimit të këtyre projektligjeve. Për 10 projektligje, të cilat synonin përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian, SHPL-ja ka hartuar opinione ligjore, kurse për 34 projektligjet e tjera, të cilat nuk synonin përafrim, por që janë shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni për Integrimin Europian, ka hartuar relacione.

Gjatë vitit 2015 përmbajtja e opinionit ligjor që harton Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit është përmirësuar edhe në një aspekt tjetër të rëndësishëm: në linjë me ndryshimet që solli hyrja në fuqi e ligjit nr. 15/2015, datë 05.03.2015 *“Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”*. Për herë të parë është sugjeruar që në rastet kur konstatohen mangësi në tabelat e përputhshmërisë që shoqërojnë projektligjet, Komisioni për Integrimin Europian të kërkojë nga institucioni propozues i projektligjit korrigjimin dhe ridërgimin e tyre në Kuvend.

Gjatë vitit 2015 Shërbimi i Përafrimit të Legjislacionit ka bashkërenduar punën me shërbimet e tjera të Kuvendit për përgatitjen e raporteve dhe informacioneve të Kuvendit në kuadër të procesit të integritit europian. SHPL-ja ka hartuar informacionin për fushat që mbulon, si dhe ka konsoliduar informacionin e dërguar nga shërbimet e tjera të Kuvendit për 10 raporte/informacione të Kuvendit në kuadër të procesit të integritit europian të Shqipërisë. Gjithashtu në bashkëpunim me Zyrën e Projekteve të Kuvendit SHPL-ja ka përgatitur draftfishën e projektit të binjakëzimit *“Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE”* në kuadër të programit IPA 2014 për Shqipërinë.




Veprimtaria e Njesisë së Përafrimit të Legjislacionit: 2013-2015



	2013	2014	2015
Projektligje	25	43	44
Opinione	22	16	10
Relacione	3	27	34
Vërejtje të sugjeruara	76	137	79
Vërejtje të pranuar	70	120	73
Raporte	8	9	10
Detyra të tjera	3	7	9

Kapitulli 2

KONTROLLI PARLAMENTAR



Veprimtaria e legjislativit është shtrirë edhe në rritjen e transparencës dhe të ushtrimit të kontrollit parlamentar, si funksion tjetër kushtetues i tij. Kuvendi, si institucioni më i lartë ligjvënës, ka ushtruar kontroll jo vetëm mbi ekzekutivin, por edhe mbi organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj për të verifikuar zbatimin e kuadrit ligjor të miratuar prej tij. Këtë kontroll Kuvendi e ka ushtruar nëpërmjet mekanizmave ligjorë të parashikuar në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Në kuadër të kompetencave të kontrollit vlejnë të theksohet kontrolli që Kuvendi ka ushtruar mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumenteve të tilla ligjore bashkëkohore si: interpelancat, kërkesat për informacion, seancat dëgjimore për çështje të zbatueshmërisë së ligjeve etj.


Kontrolli parlamentar në seancë plenare gjatë vitit 2015 paraqitet si vijon:

Interpelancat

Në kuadër të kompetencave të kontrollit vlejnë të theksohet kontrolli që ai ka ushtruar mbi ekzekutivin nëpërmjet instrumentit më të rëndësishëm ligjor: *interpelancës*.

Gjatë këtij viti janë zhvilluar 4 interpelanca si më poshtë:

- me ministrin e Mbrojtjes lidhur me përfshirjen e një efektivit të Forcave të Armatosura në veprimtari të rrezikshme kriminale si dhe për veprimtarinë e realizuar nga strukturat tona të Forcave të Armatosura për të verifikuar, parandaluar dhe zbuluar raste të tilla të rënda;
- me ministrin e Shëndetësisë lidhur me informacionet zyrtare të vjedhjes së 1,5 miliardë lekëve përmes recetave false të ilaçeve të rimbursueshme;
- me ministrin e Punëve të Jashtme lidhur me ngjarjet në Kumanovë;





- me Kryeministrin Edi Rama lidhur me bazën kushtetuese dhe ligjore ku u mbështet akti i shembjes së kishës ortodokse të *Shën Thanasit* në Dhërmi, bashkia e Himarës.

Interpelancat janë kërkuar kryesisht nga deputetë të opozitës.

Kërkesa për informacion

Ky instrument kontrolli paraqitet mbizotërues në krahasim me mjetet e tjera të kontrollit. Gjatë këtij viti numërohen 73 kërkesa të tilla drejtuar titullarëve të institucioneve shtetërore. Janë kërkuar kryesisht nga deputetë të opozitës dhe në shumicën prej tyre është marrë përgjigje brenda afatit trejavor.

Raportimet e institucioneve të pavarura

Në kuadër të kontrollit ndaj disa organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj kanë raportuar në Kuvend për veprimtarinë e tyre 15 institucione: Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Medieve Audiovizive, Avokati i Popullit, Banka e Shqipërisë, Enti Rregullator i Energjisë, Enti Rregullator i Ujërave, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Radiotelevizioni Shqiptar.

Rezoluta

Gjatë vitit 2015 Kuvendi ka miratuar 17 rezoluta.

Me anë të këtij akti Kuvendi ka vlerësuar veprimtarinë e 15 institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për vitin 2014, si dhe u ka caktuar atyre objektivat që duhet të arrijnë për vitin 2015.

Dy rezoluta kanë pasur për objekt parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBT.

Kontrolli parlamentar në komisionet e përhershme

Veprimtaria e komisioneve të përhershme parlamentare është shtrirë edhe në drejtim të forcimit të rolit kontrollues që ka Kuvendi ndaj institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Ky kontroll, seancat dëgjimore, seancat informuese dhe aktivitetet e tjera në komisione paraqiten si më poshtë:

Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut janë organizuar 39 seanca dëgjimore, nga të cilat 24 për procesin legjislativ, 8 për procesin zgjedhës dhe 7 për kontrollin parlamentar. Seancat dëgjimore për procesin legjislativ janë organizuar nga Komisioni dhe nënkomisionet, përkatësisht: 3 seanca nga Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut dhe 2 seanca nga Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore. Gjithashtu janë zhvilluar tryeza konsultimi me ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si SIGMA, EURALIUS, me gjyqtarë administrativë, anëtarë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë.

Veprimtaria e këtij Komisioni gjatë vitit 2015 ka përfshirë shqyrtimin e projektligjeve të rëndësishme, si: projektligji “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 «Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë»”; projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 «Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë»”; projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003 «Kodi i Familjes»”;



projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 «Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore»”; projektligji “Për vetëqeverisjen vendore”; projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 «Për kthimin dhe kompensimin e pronës»”; projektligji “Për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe procesin e lustracionit”; projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, projektligji “Për dhënien e amnistisë” etj.

Është rrëzuar nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut dekreti i Presidentit të Republikës nr. 8894, datë 09.01.2015 “Për kthimin e ligjit nr. 177/2014 «Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë’», i ndryshuar”.

Në fushën e të drejtave të njeriut janë miratuar projektrezolutat:

- “Për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri”;
- “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBT”.

Janë zhvilluar 7 seanca dëgjimore për shqyrtimin e 7 raporteve vjetore të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, përkatësisht raporti i Avokatit të Popullit, i Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe raporti i Ministrisë së Drejtësisë për inspektimet në Prokurori gjatë vitit 2014. Para shqyrtimit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut raportet vjetore u janë dërguar për mendim grupeve të interesit dhe institucioneve të tjera.

Projektrezolutat e diskutuara në Komision:

- “Për vlerësimin e punës së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2014”;
- “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014”;
- “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2014”;
- “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2014”;
- “Për vlerësimin veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2014.
- “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar vizita monitoruese në institucionet e vuajtjes së dënimit, si në burgun e Zaharisë etj.

Komisioni për Integrimin Europian e ka përqendruar punën e tij në funksionin legjislativ, ku është marrë kryesisht me përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë europian sipas detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit. Gjatë vitit 2015 Komisioni për Integrimin Europian ka miratuar ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji u ngrit Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian, i cili e ka përqendruar punën e tij kryesisht në kontrollin e qeverisë në procesin e integritetit europian.

Krahasuar me vitin 2014 nuk ka ndonjë dallim thelbësor në veprimtarinë e Komisionit për Integrimin Europian. Ajo që vlen të theksohet është raporti i zhdrejtë midis projektligjeve dhe projektmarëveshjeve krahasuar me vitin paraardhës. Për sa i përket raportit midis projektligjeve të shqyrtuara dhe amendamenteve të propozuara duhet theksuar se ky aktivitet krahasuar me një vit më parë ka pësuar një rritje.

Për sa i përket funksionit kontrollues në krahasim me një vit më parë duhet theksuar se Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian e ka ushtruar këtë funksion. Kjo ka qenë arsyeja që Komisioni për Integrimin Europian nuk e ka ushtruar këtë funksion për të shmangur përsëritje të aktiviteteve.



Megjithatë, gjatë shqyrtimit të projektligjeve Komisioni për Integrimin European ka pasur gjithnjë në vëmendje monitorimin e zbatimit të “*Planit kombëtar për integrimin european 2014–2020*” si dhe rekomandimet e raportit të progresit të Komisionit European për Shqipërinë për vitin 2014. Procesi i monitorimit është pasqyruar në raportet e Komisionit për Integrimin European.

Në Komisionin për Politikën e Jashtme janë zhvilluar 8 seanca për kontrollin parlamentar, konkretisht: 1) me ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Ditmir Bushati, lidhur me kërkesën e propozuar nga zoti Aldo Bumçi mbi mospranimin nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për drejtimin e Komitetit të Çështjeve Ekonomike të OSBE-së; 2) me zëvendësministren e Punëve të Jashtme, zonjën Odeta Barbullushi, lidhur me mbledhjen e përbashkët të qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës; 3) me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme rreth zhvillimeve të fundit dhe situatës në Republikën e Maqedonisë; 4) me ministrin e Punëve të Jashtme, zotin Ditmir Bushati, mbi zhvillimet e fundit politike në Kosovë dhe ndikimin e tyre në rajon; 5) me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me OSBE-në dhe Këshillin e Europës; 6) seancë informuese me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe projektet e përbashkëta me agjencitë e kësaj organizate në Shqipëri; 7) seancë informuese me përfaqësues të lartë të Ministrisë së Punëve të Jashtme mbi angazhimin diplomatik të qeverisë shqiptare për zgjidhjen e krizës së refugjatëve në Europë dhe të azilkërkuesve shqiptarë në Gjermani; 8) seancë informuese me përfaqësues të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë rreth masave të marra nga qeveria shqiptare për zgjidhjen e problematikës së azilkërkuesve në Gjermani, përgatitjet për kthimin e tyre, si dhe përgatitjet për një valë të mundshme të refugjatëve nga zonat e luftës, që mund ta përdorin Shqipërinë si vend transiti.

Gjithashtu janë zhvilluar tri seanca dëgjimore me kandidatët për ambasadorë të jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë, konkretisht: me zotin Fatos Reka në Republikën e Maqedonisë; me zotin Visar Zhiti pranë Selisë së Shenjtë, Vatikan, rezident, si dhe pranë Urdhrit Sovran Ushtarak të Maltës, jorezident; me zotin Bardhyl Canaj në Izrael; me znj. Ravesa Lleshi, kandidate për ambasadore, përfaqësuese e përhershme e Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara, OSBE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare në Vjenë; me zotin Ermal Muça, kandidat për ambasador në Kanada; me znj. Enkeleda Mërkuri, kandidate për ambasadore në Republikën e Sllovakisë; me zotin Arian Spasse, kandidat për ambasador në Republikën e Hungarisë; me zotin Ermal Dredha, kandidat për ambasador në Emiratet e Bashkuara Arabe.

Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat janë zhvilluar këto seanca dëgjimore: seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”; seancë dëgjimore me shoqatat e biznesit për projektligjet financiare që shoqërojnë projektbuxhetin e vitit 2016; për raportin mbi veprimtarinë vjetore të Autoritetit të Konkurrencës; për raportin mbi veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave; për raportin mbi veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare; për raportin mbi veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2014; për raportin mbi veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit; për raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2014.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare gjatë kësaj periudhe e ka ushtruar të drejtën e kontrollit parlamentar në dy drejtime, duke zhvilluar 5 seanca dëgjimore gjatë kontrollit parlamentar: me ministrin e Brendshëm, zotin Sajmir Tahiri, lidhur me angazhimin e strukturave të Policisë së Shtetit për zbardhjen e ngjarjes së fundit të ndodhur në fshat Lazarat; me ministrin e Brendshëm, zotin Sajmir Tahiri, lidhur me masat e parashikuara për luftën kundër terrorizmit; me ministren e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, lidhur me masat e parashikuara për luftën kundër terrorizmit; me kreun e SHISH-it, zotin Visho Ajazi



(Lika), lidhur me masat e parashikuara për luftën kundër terrorizmit; raportim vjetor i Drejtorisë s, Përgjithshme t, Parandalimit dhe Pastrimit t, Parave.

Në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin janë zhvilluar këto aktivitete: diskutimi dhe miratimi i vendimit për Këshillin Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP). Projektvendimi “Për propozimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për emërimin e katër anëtarëve të Këshillit Drejtues të AKEP-it”; diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Ujërave për vitin 2014”; diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2014”; diskutimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë vjetore të AKEP-it për vitin 2014”; diskutimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 9205, datë 07.08.2015 “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 93/2015 «Për turizmin»”; mbledhje për marrëdhëniet e ndërsjella me komisionin homolog të Kuvendit të Kosovës; takim me ekspertë të *Columbia Centre for Sustainable Investments* (CCSI) lidhur me transparencën në industrinë nxjerrëse; takim në Ersekë: mbikëqyrja legislative mbi çështjen e pyjeve (OSBE); takim në Korçë: mbikëqyrja legislative në çështjet e mjedisit dhe bujqësisë (OSBE); vizitë pune në deltën e lumit Ishëm; vizitë pune në landfillin e Maliqit; vizitë në Përmet dhe Langaricë; prezantimi i raportit vjetor të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nga drejtori ekzekutiv i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, zoti Kopac.

Edhe në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë janë zhvilluar seanca dëgjimore në ushtrim të funksionit të kontrollit parlamentar. Komisioni ka zhvilluar seancë dëgjimore me ministrin e Shëndetësisë dhe ministren e Arsimit për specializimet në mjekësi; seancë dëgjimore me grupet e interesit për diskutimin e deklaratës së dhënë nga ministri i Shëndetësisë në lidhje me testimin e mjekëve në të gjithë vendin. Gjithashtu komisioni ka thirrur për të dhënë informacion ministrin e Shëndetësisë lidhur me testimin e mjekëve në të gjithë vendin dhe për shkurtimet në personelin shëndetësor në sistemin spitalor në rrethe.

Nënkomisioni për Çështjet e të Miturve, Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje ka zhvilluar një seancë dëgjimore publike për shqyrtimin e raportit të veçantë të Avokatit të Popullit “Për dhunën ndaj gruas”, si dhe për diskutimin e hapave konkretë për reduktimin e dhunës me bazë gjinore me organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në këtë fushë.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar seancë dëgjimore me Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës (FSASH), Sindikatën e Pavarur të Arsimit (SPA), Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) dhe Federatën e Sindikatave të Punonjësve të Arsimit, Edukimit dhe Shkencës të Shqipërisë (FSPAESH) për çështjen e testimit të mësuesve; seancë dëgjimore me ministrin e Arsimit dhe Sportit, znj. Lindita Nikolla, lidhur me çështjen e testimit të mësuesve; me kryesinë e Akademisë së Shkencave lidhur me veprimtarinë shkencore të institucionit gjatë vitit 2014; me përfaqësues të Agjencisë së Kërkimit të Teknologjisë dhe Inovacionit për programet e kërkimit shkencor, gjendjen aktuale dhe të ardhmen e AKTI-së; me drejtuesit e Radiotelevizionit Shqiptar për raportin mbi veprimtarinë e RTSH-së gjatë vitit 2014; me drejtuesit e Autoritetit të Medies Audiovizive për raportin e veprimtarisë së AMA-s gjatë vitit 2014; me institucionin e Avokatit të Popullit lidhur me testimin e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për emërimet e mësuesve dhe vlerësimin mësuesve aktualë; me znj. Lindita Nikolla lidhur me përgatitjen e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të institucioneve të tjera ligjzbatuese për mbarëvajtjen e vitit të ri arsimor 2015–2016 në sistemin arsimor parauniversitar; me ministrin e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, zotin Blendi Klosi, lidhur me fillimin e vitit të ri shkollor në sistemin parauniversitar në arsimin profesional.

Ushtrimi sa më efikas dhe transparent i kontrollit parlamentar mbi organet e pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj që raportojnë dhe informojnë Kuvendin e Shqipërisë, duke respektuar parimin kushtetues *check and balance*, siguron një mjet vital në realizimin e kontrollit parlamentar edhe ndaj qeverisë, politikave e strategjive të zbatueshme të saj, si dhe impaktit



që ato kanë pasur në forcimin e shtetit të së drejtës.

Kuvendi i Shqipërisë ka një sërë mekanizmesh për monitorimin e legjislacionit dhe kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të pavarura dhe efikasitetin e veprimtarisë së tyre specifike të rregulluara me ligjet përkatëse nëpërmjet mekanizmit të:

- raportimit nga ana e tyre në Kuvend;
- alokimit të fondeve buxhetore;
- miratimit të strukturave dhe kategorizimit të pagave;
- propozimeve dhe dhënies së mendimit për amendamente të ligjit;
- emërimit të anëtarëve në organet kolegjiale dhe titullarëve në ato monokratike;
- shkarkimit të anëtarëve në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj.

Për realizimin e këtyre raporteve jep ndihmesën e vet Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura (SHMI) në Kuvendin e Shqipërisë.

Kuvendi i Shqipërisë gjatë vitit 2015 e ka ushtruar funksionin e kontrollit parlamentar jo vetëm ndaj qeverisë, por paralelisht ka monitoruar edhe punën e institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj duke u bazuar në kuadrin kushtetues dhe legjislacionin e veçantë të këtyre institucioneve, si dhe mbështetur në procedurat parlamentare që përcakton Rregullorja e Kuvendit.

Për bashkëveprimin e ngushtë të Kuvendit me institucionet e pavarura dhe rrjedhimisht edhe për kontributin mbështetës të Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ndaj organeve të Kuvendit në këtë drejtim dëshmon edhe raporti i fundit i progresit i Komisionit Europian për Shqipërinë, publikuar në nëntor 2015, i cili është shprehur për monitorimin e punës së institucioneve se *“Kuvendi ka vazhduar të monitorojnë punën e institucioneve të pavarura dhe ka shqyrtuar raportet e tyre në mënyrë më të shpejtë dhe më të plotë”*.

Gjithsej janë zhvilluar 24 seanca dëgjimore në komisionet e përhershme parlamentare për raportet vjetore të punës së institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj (Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Autoriteti i Konkurrencës, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Autoriteti i Medieve Audiovizive, Avokati i Popullit, Banka e Shqipërisë, Enti Rregullator i Energjisë, Enti Rregullator i Ujërave, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Shqiptar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit), si dhe 16 seanca për shqyrtimin dhe miratimin e projektrezolutave në komisionet përgjegjëse pas përfundimit të seancave dëgjimore me institucionin, për t'ia përcjellë më pas seancës plenare për votim.

Komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar 38 mbledhje me tematikë raportimin vjetor të institucioneve të pavarura dhe vlerësimin e punës së tyre për vitin paraardhës: 22 mbledhje gjatë fazës së prezantimit të raportit vjetor dhe seancës së pyetjeve-përgjigjeve e diskutimeve dhe 16 mbledhje për miratimin e projektrezolutave mbi veprimtarinë vjetore të institucioneve të pavarura.

Gjatë fazës së miratimit të buxhetit të këtyre institucioneve janë zhvilluar 9 seanca dëgjimore me përfaqësues të këtyre institucioneve të pavarura: Avokati i Popullit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Prokuroria e Përgjithshme, radiotelevizioni Shqiptar.

Lidhur me propozimet për ndryshime në strukturën e institucioneve të pavarura janë zhvilluar 9 seanca dëgjimore, në varësi të kërkesave të institucioneve për ndryshime në strukturë apo miratim



strukturash. Janë miratuar ndryshimet në strukturën e Autoritetit të Konkurrencës, ka ndryshuar dy herë struktura e ILDKPKI-së, AMA-s, AKEP-t. Po ashtu me vendim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik është përcaktuar dhe më tej është votuar në Kuvend masa e shpërblimit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar, një praktikë e re parlamentare e sanksionuar në ligjin 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Janë zhvilluar 5 seanca të tjera dëgjimore për çështje të veçanta të veprimtarisë së institucioneve dhe nivelin e zbatimit të ligjit, si: shqyrtimi i raportit të Avokatit të Popullit “Për dhunën ndaj gruas” nga Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut; shqyrtimi i rezolutës së gjakmarrjes në Komisionin e Ligjeve, votuar në seancë plenare; seancë dëgjimore me Avokatin e Popullit për testimin e mësuesve, seancë dëgjimore me Kontrollin e Lartë të Shtetit për zbatimin e buxhetit të vitit 2014; informacion për buletinet e auditimeve nga KLSH-ja; seancë dëgjimore me guvernatorin e Bankës së Shqipërisë për dhënie opinionit për buxhetin e shtetit për vitin 2016 etj.

Janë votuar nga Kuvendi edhe dy rezoluta pas shqyrtimit të raporteve të veçanta të Avokatit të Popullit, përkatësisht: rezoluta “Për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në Shqipëri” dhe rezoluta “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBT”.

Kuvendi ka vijuar aktivitetin e tij mbikëqyrës me fokus bashkërendimin e punës me institucionet e pavarura, duke rritur pjesëmarrjen dhe marrjen e mendimit të këtyre institucioneve gjatë procesit ligjvënës, po ashtu dhe për treguesit e zbatimit të legjislacionit, të përmbushjes së detyrimeve përkatëse sipas udhërrëfyesit të pesë prioritetëve të anëtarësimit në BE, duke u informuar më shpesh dhe trajtuar çështjet e raportuara nga institucionet lidhur me rekomandimet përkatëse të adresuara prej tyre ndaj administratës publike dhe në përgjithësi për përmirësime ligjore në përputhje me standardet e *aquis*. Kjo ndjekje periodike nga ana e Kuvendit ka afruar komunikimin dhe bashkëpunimin në linjë direkte me institucionet, duke sjellë kështu rritje të transparencës dhe të llogaridhënies.


Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ka paraqitur oponencën për 18 raporte vjetore të këtyre institucioneve të pavarura: Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Autoriteti i Konkurrencës (AK), Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), Autoriteti i Medieve Audiovizive (AMA), Avokati i Popullit (AP), Banka e Shqipërisë (BSH), Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Enti Rregullator i Ujërave (ERRU), Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), Këshilli Drejtues i Radiotelevizionit Shqiptar (KDRTSH), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP), Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), Prokuroria e Përgjithshme (PP). Po ashtu ka paraqitur një raport për inspektimet e Ministrisë së Drejtësisë në Prokurori në Komisionin për Çështjeve Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në Komisionin për Mjetet e Edukimit dhe të Informimit Publik dhe në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura ka adresuar të gjitha problematikat, arritjet dhe kërkesat në vijim të përmbushjes së objektivave të punës së tij. Në mënyrë të përmbledhur, secili nga komisionet është ndihmuar me materiale nga Shërbimi i Monitorimit si më poshtë:

- a) Komisionit për Ekonominë dhe Financat i janë ofruar 28 materiale me shkrim;
- b) Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i janë ofruar 44 materiale me shkrim;
- c) Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik i janë ofruar 29 materiale me shkrim;
- d) Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin i janë ofruar 28 materiale me shkrim.

Kapitulli 3

FUNKSIONI ZGJEDHËS




Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi i titullarëve dhe anëtarëve të institucioneve monokratike dhe kolegjiale, kushtetuese dhe të krijuara me ligj është një detyrim që rrjedh nga Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit dhe ligjet organike.

Komisionet e përhershme, në përmbushje të kërkesave procedurale të parashikuara në nenet 111, 114 dhe 115 të Rregullores së Kuvendit, gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore kanë kërkuar përmbushjen jo vetëm të kriterëve kushtetuese dhe ligjore të kandidaturave të paraqitura, por kanë bërë edhe vlerësimin e

meritës dhe të profesionalizmit mbi bazën e respektimit të parimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes.

Në vijim, në seancë plenare Kuvendi ka vendosur për çdo kandidaturë të propozuar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj si më poshtë:

- 2 vendime për mosdhënie pëlqimi për kandidaturat e propozuara për anëtar të Gjykatës së Lartë;
- 2 vendime për miratim dekreti për emërim ministri;
- 1 vendim për miratim dekreti për shkarkim ministri;
- 16 vendime për zgjedhje;
- 3 vendime për emërim.





Kapitulli 4

VEPRIMTARIA E ORGANEVE TË KUVENDIT

Veprimtaria e organeve drejtuese të Kuvendit

Gjatë vitit 2015 organet drejtuese kanë zhvilluar mbledhje për trajtimin e çështjeve të ndryshme që, sipas Rregullores, janë në kompetencën e tyre:

- *Konferenca e Kryetarëve* ka zhvilluar 25 mbledhje për miratimin e programit të punës, të kalendarit trejavor, të kalendarit të shqyrtimit të buxhetit dhe të paketës fiskale, të kalendarit të raportimeve të disa institucioneve kushtetuese dhe atyre të ngritura me ligj; kërkesa për ndryshim të rendit të ditës, për ngritjen e komisioneve hetimore dhe komisioneve të posaçme, propozime për ndryshime në komisionet e përhershme etj.

- *Byroja e Kuvendit* ka zhvilluar 6 mbledhje për çështje administrative dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit, masa disiplinore ndaj deputetëve që kanë shkelur rëndë punimet parlamentare në seancë plenare etj.

- *Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin* ka zhvilluar 13 mbledhje për verifikim mandati, çështje që lidhen me mandatin e deputetit, dhënie autorizimi për arrestim, heqje lirie, kontroll banese dhe personal të deputetëve.

Krijimi i strukturave të reja parlamentare

Gjatë vitit 2015 Kuvendi ka krijuar strukturat parlamentare si më poshtë:

- Me vendimin nr. 28/2015 ka vendosur ngritjen e Nënkomisionit për Administratën Publike në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Objekti dhe fusha e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni është administrata publike.

- Me vendimin nr. 32/2015 Kuvendi ka ngritur Komisionin e Posaçëm për Zbatimin e Problematikës në Rezolutën për Marrëveshjen Midis Mazhorancës Qeverisëse dhe Opozitës në Kuvendin e Shqipërisë. Në përfundim të veprimtarisë së tij Komisioni i Posaçëm i paraqiti seancës plenare dy projektligje:

- “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 «Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar”.

- Me vendimin 90/2015 Kuvendi ka ringritur Komisionin Hetimor për Verifikimin e Ligjshmërisë së Emërimeve në Detyrë në Administratën Shtetërore, Entet Publike dhe Shoqëritë Tregtare Shtetërore për periudhën 15 shtator 2013–30 shtator 2015.

- Me vendimin 89/2015 ka ringritur Komisionin Hetimor për Kontrollin e Zbatimit të Legjislacionit në Fuqi për Administrimin e Bazave të të Dhënave Shtetërore Tatimore.

- Me vendimin nr. 110/2015 është ngritur Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore, i cili do të zhvillojë veprimtarinë e tij gjatë vitit 2016.



Zgjedhja e dy zëvendëskryetarëve të Kuvendit dhe sekretarit të Sekretariatit për Procedurat dhe Votimin

Kuvendi me vendimet nr. 61/2015 dhe 76/2015 ka zgjedhur në postin e zëvendëskryetarëve të Kuvendit deputetët Shpëtim Idrizi (PDIU) dhe Valentina Leskaj (PS), ndërsa me vendimin 64/2015 zgjodhi deputetin Musa Ulqini sekretar të Sekretariatit për Procedurat dhe Votimin.

Lëvizjet në grupet parlamentare

Gjatë vitit 2015 ka pasur largime të deputetëve nga grupet parlamentare në të cilat ishin anëtarësuar. Duke qenë se përbërja e grupeve ra nën nivelin minimal (7 deputetë), kjo në muajt prill–maj shkaktoi pushimin e ekzistencës së dy grupeve parlamentare: të Grupit Parlamentar të Partisë Republikane dhe të Grupit Parlamentar të partisë “Drejtësi, Integritet dhe Unitet”.

Të dyja grupet u riformatuan sërish në muajt nëntor–dhjetor 2015, pas plotësimit të numrit të domosdoshëm.

Dorëheqjet nga mandati

Gjatë vitit 2015 dhanë dorëheqjen nga mandati për shkak të kandidimit në zgjedhjet lokale deputetët Artur Bushi, Ardian Turku, Miranda Rira, Armando Subashi, Majlinda Bufi, Besnik Dushaj, Halim Kosova dhe Voltana Ademi. Gjithashtu për arsye personale dhanë dorëheqjen edhe deputetët Arben Ndoka dhe Mark Frroku.

Deputetët e rinj

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u dha mandatin e deputetit kandidatëve të radhës të listës shumëmemërore të partisë respektive në atë qark. Për sa i përket procedurës së dhënies së mandatit u respektua neni 164, pika 2 e ligjit nr. 10.019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Për deputetët e rinj nuk rezultoi asnjë paligjshmëri në zgjedhje, që t’i pengonte ata të bënë betimin në seancë plenare. Në mbështetje të nenit 4, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, deputetët e rinj bënë betimin, si kusht për të filluar ushtrimin e mandatit të deputetit.

Deputetët e rinj që bënë betimin gjatë vitit 2015 janë më poshtë:

Shkëlqim Troplini (qarku Durrës), Arbjola Halimi (qarku Elbasan), Edlira Çekrezi (qarku Elbasan), Bujar Çela (qarku Fier), Antoneta Dhima (qarku Fier), Mimoza Hajdarmataj (qarku Kukës), Eduart Ndocaj (qarku Lezhë), Asllan Dogjani (qarku Tiranë), Irma Kopliku (qarku Shkodër), Mirela Ferracaku (qarku Shkodër).

Kërkesa për të konstatuar papajtueshmëri me mandatin e deputetit

Gjatë vitit 2015 Kuvendi ka shqyrtuar 2 kërkesa të paraqitura nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për çështjen e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit për zotin Koço Kokëdhima dhe zonjën Valentina Leskaj.

Kuvendi është shprehur si më poshtë për këto kërkesa:

- Vendim nr. 48/2015 “Për mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë me detyrën e deputetit të zotit Koço Kokëdhima”.

- Vendim nr. 101/2015 “Për mosmiratimin e kërkesës së një grupi prej 22 deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike me objekt “Konstatimi i mbarimit të mandatit të deputetes të zonjës Valentina Leskaj”.



Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në dhjetor 2015 ka paraqitur një kërkesë tjetër për mocion për konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Rakip Suli. Kjo kërkesë do të shqyrtohet në vitin 2016.

➤ **Dhënie autorizimi për arrestim ose heqje lirie, kontroll personal ose banesë për deputetë të Kuvendit të Shqipërisë**

Kuvendi gjatë vitit 2015 ka shqyrtuar 4 kërkesa të Prokurorit të Përgjithshëm për dhënie autorizimi për arrestim ose heqje lirie, kontroll personal ose banesë për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë Tomë Doshi, Mark Frroku dhe Armando Prenga. Në përfundim Kuvendi ka marrë vendimet e mëposhtme:

- Vendim nr. 39/2015 “Për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë si dhe për të ushtruar kontroll personal dhe të banesave të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Tomë Doshi”.
- Vendim nr. 40/2015 “Për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë si dhe për të ushtruar kontroll personal dhe të banesave të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Mark Frroku”.
- Vendim nr. 42/2015 “Për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Mark Frroku”.
- Vendim nr. 83/2015 “Për mosheqjen e masës së arrestit në flagrancë dhe për dhënien e autorizimit për arrestimin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë Armando Prenga”.



Kapitulli 5

VEPRIMTARIA NDËRKOMBËTARE

Gjatë vitit 2015 në fokus të veprimtarisë të marrëdhënieve me jashtë ka qenë forcimi dhe aktivizimi i marrëdhënieve ndërparlamentare me vendet anëtare të BE-së, me vendet e rajonit dhe me vende me të cilat vendi ynë ka interesa strategjike. Viti 2015 ishte një vit mjaft i rëndësishëm për sa i përket veprimtarive ndërkombëtare parlamentare dhe diplomacisë parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë kuadër një sërë veprimtarish të marrëdhënieve me jashtë kishin si objektiv:

- *intensifikimin e punës në nivel parlamentar për avancimin me axhendën europiane të Shqipërisë;*
- *intensifikimin e kontakteve mes parlamenteve të vendeve të ndryshme, me synim nxitjen e mëtejshme të diplomacisë parlamentare;*
- *intensifikimin e bashkëpunimit rajonal, me synim nxitjen e projekteve të përbashkëta, forcimin e bashkëpunimit ekonomik mes këtyre vendeve;*
- *njohjen e vendit tonë dhe të potencialeve që ai ofron për të thithur investimet e huaja.*

Për arritjen objektivave të veprimtarisë së marrëdhënieve me jashtë Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar një axhendë mjaft të ngjeshur me aktivitete të shumta në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe dhe shumëpalëshe, e cila e përmbledhur është si më poshtë:

- **5 vizita zyrtare të Kryetarit të Kuvendit në vende të tjera;**
- *4 vizita zyrtare të kryetarëve të parlamenteve të vendeve të ndryshme të botës në Shqipëri¹*
- *5 pjesëmarrje të delegacioneve parlamentare të kryesuara nga Kryetari në veprimtari shumëpalëshe;*
- *6 takime shumëpalëshe të organizuara nga Kuvendi i Shqipërisë;*
- *5 vizita zyrtare në Tiranë të grupeve parlamentare të miqësisë të parlamenteve të vendeve të ndryshme dhe 1 vizitë e grupit të miqësisë Shqipëri–Francë në Francë;*
- *8 vizita të delegacione nga komisionet e Kuvendit pranë komisioneve homologe të në vende të tjera si dhe 4 vizita nga komisione parlamentare të vendeve të tjera në Kuvendin e Shqipërisë;*
- *90 pjesëmarrje në aktivitetet në kuadër të organizatave shumëpalëshe, takime rajonale, forume, seminare;*
- *72 takime të Kryetarit të Kuvendit me personalitete të huaja: presidentë, kryeministra, ministra,*

1. Në këtë shifër nuk janë përfshirë vizita e kryetarit të parlamentit të Kroacisë, vizita e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, kryetarit të parlamentit të Malit të Zi, kryetarit të parlamentit të Maqedonisë, kryetarit të parlamentit të Sllovenisë dhe atij të Turqisë, që vizituan Shqipërinë në kuadër të pjesëmarrjes në sesionin e SEECP-it dhe që gjatë qëndrimit të tyre në Tiranë realizuan dhe takime dypalëshe.



delegacione parlamentare e personalitete të tjera të shquara;

- 80 takime të kryetarëve të komisioneve, të kryetarëve të delegacioneve në organizata shumëpalëshe dhe të deputetëve me personalitete të huaja.

Vlen të theksohet se gjatë periudhës qershor 2014–qershor 2015 vendi ynë ka pasur presidencën e radhës të Procesit të Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECp), i cili mbetet forumi më i rëndësishëm politik në Europën Juglindore, që synon bashkëpunim për paqen, sigurinë, stabilitetin, zhvillimin ekonomik, politik e shoqëror të gjithë vendeve të rajonit. Forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë mes vendeve të rajonit, transformimi i rajonit në një zonë të paqes, sigurisë, stabilitetit dhe bashkëpunimit janë objektivat themelorë të SEECp-it.

Në kuadër të kësaj presidence Kuvendi i Shqipërisë ka pasur angazhimin për realizimin e disa takimeve dhe aktiviteteve, të cilat kulmuan me organizimin e sesionit plenar të Asamblesë Parlamentare të SEECp-së më 21–23 maj 2015. Në këtë sesion plenar morën pjesë 13 delegacione parlamentare nga vendet anëtare, 6 prej të cilave kryesoheshin nga kryetarë parlamentesh si: kryetari i parlamentit të Kroacisë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, kryetari i parlamentit të Malit të Zi, kryetari i parlamentit të Maqedonisë, kryetari i Kuvendit të Shqipërisë dhe kryetari i parlamentit të Turqisë.

Ky sesion, i dyti në historinë e krijimit të Asamblesë Parlamentare të SEECp-së, ishte një sesion mjaft i suksesshëm, ku me rëndësi të veçantë ishte dhe anëtarësimi i Kosovës me të drejta të plota në këtë nismë.

Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë, ashtu si dhe shërbimet e tjera të Kuvendit të Shqipërisë, ka qenë maksimalisht i angazhuar në punën parapërgatitore për organizimin në Tiranë të sesionit të 10-të plenar të PAM më 18–19 shkurt 2016 dhe sesionit të pranverës të Asamblesë Parlamentare të NATO-s më 27–30 maj 2016, që përbën aktivitetin më të rëndësishëm të organizuar ndonjëherë në Shqipëri.

Aktivitete në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe

Në funksion të zgjerimit të kontakteve dhe intensifikimit të bashkëpunimit me parlamentet e vendeve të tjera si dhe nxitjes së diplomacisë parlamentare, shkëmbimet në nivel dypalësh kanë qenë mjaft aktive dhe të kënaqshme. Në këtë kuadër Kryetari i Kuvendi ka realizuar 5 vizita zyrtare jashtë vendit, dhe konkretisht: Ceki, Maqedoni, Zvicër, SHBA, Gjermani dhe Itali.

19–21 janar 2015: vizitë e Kryetarit të Kuvendit, zotit Ilir Meta, në Maqedoni. Zoti Meta në këtë vizitë shoqërohej nga një delegacion i përbërë nga kryetari i Grupit të Miqësisë Shqipëri–Maqedoni, zoti Ilir Xhakolli, dhe deputetët Luan Rama, Pirro Kapurani, Fatmir Toçi dhe Mesila Doda, anëtarë të këtij grupi.

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë u prit nga homologu i tij, zoti Trajko Veljanovski, si dhe zhvilloi takime me zotin Orhan Ibraimi, kryetar i grupit parlamentar të parlamentit të Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarët e këtij grupi; me kryetarin e qeverisë së Republikës së Maqedonisë, zotin Nikolla Gruevski, dhe Presidentin e Republikës së Maqedonisë, zotin Gjorge Ivanov.

25–27 janar 2015: pjesëmarrje e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Ilir Meta, në Forumin e Katërt Ndërkombëtar “*Let my people live!*” me rastin e ceremonisë së 70-të përkujtimore të holokaustit, zhvilluar në Pragë. Gjatë qëndrimit në Pragë u zhvilluan dhe takime dypalëshe.

Kryetari i Kuvendit mori pjesë në tryezën e rrumbullakët të kryeparlamentarëve të drejtuar nga



presidenti i Parlamentit European, zoti Martin Shulc.

Gjatë ndërhyrjes së tij në forum z. Meta u shpreh se më shumë se kurrë sot në Europë duhet të kujtojmë çfarë ka ndodhur në të shkuarën, por ç'është më e rëndësishmja ne duhet t'u mësojmë brezave të rinj si të parandalojnë goditjen e së ardhmes sonë nga mentalitetet raciste, që ushqejnë kushtet e nevojshme sociale për akte dhune kriminale ose antisemitike.

17–19 mars 2015: vizitë e Kryetarit të Kuvendit, z. Ilir Meta, në Zvicër. Gjatë qëndrimit në Zvicër Kryetari i Kuvendit shoqërohej nga deputetët Fatmir Toçi, kryetar i Grupit Parlamentar të Miqësisë Shqipëri–Zvicër, Fatmir Xhafaj, kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, dhe Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit, znj. Albana Shtylla.

Kryetarit të Kuvendit u prit në Bernë nga Presidenti i Parlamentit të Zvicrës, zoti Stephane Rossini, nga sekretari i Shtetit në Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme të Zvicrës, z. Yves Rossier, dhe nga kryetari i bashkisë së Bernës, z. Alexandër Tschappat.

30 tetor–2 nëntor: Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, zhvilloi një vizitë disaditore në SHBA. Gjatë qëndrimit në SHBA Kryetari i Kuvendit zhvilloi disa takime me zyrtarë të nivelit të lartë, kongresmenë dhe senatorë.

28 nëntor–2 dhjetor: Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, mori pjesë në aktivitetin e organizuar me rastin e ditëve të nëntorit shqiptar në Dyseldorf (Gjermani). Ekspozita me rastin e festës kombëtare shqiptare ishte pjesë e një serie aktivitetesh të organizuara në këtë Land nën moton “Nëntori shqiptar në Landin e Vestfalisë së Renit të Veriut”. Kjo ekspozitë titullohej “Shqipëria përmes syve të brezit të artistëve 1912–2015”. Në këtë aktivitet ishte e pranishme edhe ministrja e Kulturës, z. Mirela Kumbaro.

Gjatë vizitës në Dyseldorf Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, zhvilloi takime me komisionin parlamentar të çështjeve europiane e ndërkombëtare dhe komisionin e ekonomisë së Landit të Vestfalisë së Renit të Veriut.

Me ftesë të Kryetarit të Kuvendit janë realizuar këto vizita të kryetarëve të vendeve të tjera në Shqipëri: vizitë zyrtare në Tiranë e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli; vizitë zyrtare e kryetarit të parlamentit të Suedisë, z. Urban Ahlin; vizitë zyrtare e kryetares së parlamentit të Serbisë, znj. Maja Gojkovic.

10 Shkurt 2015: Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, priti kryetarin e Kuvendit të Kosovës, z. Kadri Veseli, i cili shoqërohej nga nënkryetarët e Kuvendit të Kosovës Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca.

Dy kryetarët e parlamenteve, z. Meta dhe z. Veseli, vlerësuan marrëdhëniet shumë të ngushta mes Shqipërisë dhe Kosovës dhe diskutuan mbi intensifikimin e bashkëpunimit dypalësh si në aspektin ndërparlamentar, ashtu dhe në drejtim të rritjes së vëllimit të shkëmbimeve ekonomike e tregtare.

24 shkurt 2015: Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, priti kryetarin e parlamentit të Suedisë (Riksdag), z. Urban Ahlin. Dy kryetarët e parlamenteve vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera që ekzistojnë mes dy vendeve dhe diskutuan mbi intensifikimin e shkëmbimeve parlamentare dhe ekonomike. Gjatë takimit mes dy delegacioneve z. Meta shprehu mirënjohjen për mbështetjen e pakursyer të Suedisë në procesin e integritetit european të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera të rajonit, duke vënë në dukje se Suedia mbetet një shembull i demokracisë dhe ekselencës institucionale.

4–5 mars 2015: kryetarja e Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë, znj. Maja Gojković, zhvilloi një vizitë zyrtare në Shqipëri në krye të një delegacioni parlamentar. Delegacioni u prit nga



Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta. Zoti Meta vlerësoi se kjo vizitë e parë historike e një kreu të parlamentit të Serbisë në Tiranë konfirmon stadin pozitiv të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Serbisë.

Gjatë takimit u bisedua mbi mundësinë e intensifikimit të kontakteve dhe forcimit të marrëdhënieve dypalëshe midis Shqipërisë dhe Serbisë e në veçanti mbi thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërparlamentar midis dy vendeve përmes grupeve të respektive miqësisë, përmes bashkëpunimit të komisioneve parlamentare dhe administratave.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar rreth 72 takime të Kryetarit të Kuvendit me personalitete të ndryshme ndërkombëtare, si p.sh.: takim me ministrin e Jashtëm të Belgjikës, z. Didier Reynders; me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme të Sllovakisë Miroslav Lajcak; me Presidentin e Turqisë, Rexhep Taip Erdogan; me Presidentin e Maqedonisë, George Ivanov; me sekretarin e Shtetit të Italisë për Çështjet Europiane, z. Gozzi; me Komisionerin për Zgjerimin të BE, z. Johannes Hahn; me kryeministrin e Serbisë, z. Aleksandër Vuçiç; me sekretarin e përgjithshëm të OSBE-së, z. Lamberto Zanieri; me Presidenten e Kosovës, z. Ahtifete Jahjaga; me ministrin e Punëve të Jashtme të Greqisë, z. Nikos Kotsias; me presidentin e grupit socialist në Parlamentin Europian, z. Gianni Pitella; me ministren e Mbrojtjes të Gjeorgjisë, z. Tinatin Khidasheli etj.

Shkëmbimet e vizitave dypalëshe në kuadër të delegacioneve nga komisionet parlamentare gjithashtu kanë qenë mjaft intensive. Janë realizuar shtatë vizita të delegacioneve nga komisionet parlamentare të Kuvendit, si më poshtë:

- vizita e një përfaqësie të Komisionit për Integrimin Europian në parlamentin e Çekisë;
- vizita e një përfaqësie të Komisionit për Politikën e Jashtme në parlamentin e Çekisë;
- vizita e një përfaqësie të Komisionit për Politikën e Jashtme në Gjermani;
- vizita e një përfaqësie të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Republikën e Kosovës;
- vizita e një përfaqësie të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i Ligjeve në Turqi;
- vizita e një përfaqësie të Komisionit për Sigurinë Kombëtare në Bundestagun gjerman;
- vizita e një përfaqësie të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut i Ligjeve në Gjermani.

Vizita në nivel komisionesh parlamentare ka pasur dhe nga parlamentet e vendeve të tjera në Kuvendin e Shqipërisë, si:

- vizita e delegacionit të Komisionit të Integritetit të parlamentit çek në Tiranë;
- vizita e një delegacioni të parlamentit të Koresë së Jugut;
- tri vizita të delegacioneve të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Kosovës në Shqipëri, përkatësisht të Komisionit të Medies, Komisionit të Veprimtarive Prodhuese dhe Komisionit të Ligjeve.

Aktivitetet në kuadër të organizatave shumëpalëshe

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i Kuvendit të Shqipërisë në veprimtaritë shumëpalëshe ka qenë mjaft i gjerë. Kryetari i Kuvendit ka marrë pjesë në disa veprimtari shumëpalëshe, si:

19–22 prill 2015: Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, zhvilloi një vizitë disaditore në Itali, ku mori pjesë në konferencën e kryetarëve të parlamenteve të vendeve të BE-së. Gjatë kësaj vizite z. Meta u prit në Romë nga presidenti i Senatit Italian, z. Pietro Grasso, me të cilin bisedoi rreth partneritetit të ngushtë mes Shqipërisë dhe Italisë. Presidenti i Senatit Italian theksoi se Italia është gjithnjë pranë dhe



përkrah Shqipërisë gjatë procesit të integrimit europian.

Vizitat e delegacionit vazhduan edhe në Kalabri, ku pati takime me autoritetet arbëreshe të disa komunave.

15 tetor 2015: pjesëmarrje e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, në konferencën parlamentare të nivelit të lartë për ndryshimet klimaterike të zonës euromesdhetare në Paris. Gjatë punimeve të kësaj konference Kryetari i Kuvendit u takua me presidentin e Asamblesë Kombëtare të Francës, z. Claude Bartolone; me kryetarin e Dhomës së Përfaqësuesve të Mbretërisë së Marokut, z. Rachid Talbi el Alami; me zëvendëspresidentin e Parlamentit Europian, z. David Sassoli; me kryetarin e Parlamentit të Qipros, z. Yiannakis Omirou; me kryetaren e Komisionit të Punëve të Jashtme të parlamentit francez, znj. Elisabeth Gigou, si dhe me përfaqësues të tjerë pjesëmarrës në konferencë.

13 shtator 2015: Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, merr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare mbi Transparencën Parlamentare, e cila u zhvillua në Tbilisi.

16 tetor 2016: Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, merr pjesë në Konferencën e 7-të të Kryetarëve të Parlamenteve të Vendeve të Ballkanit Perëndimor, që u zhvillua në Budapest (Hungari).

Integrimi në Bashkimin Europian mbetet objektivi ynë kombëtar madhor e si rrjedhim në fokus të veprimtarisë së marrëdhënieve me jashtë të Kuvendit ka qenë intensifikimi i lidhjeve të krijuara, pjesëmarrja në takime pune dhe seminare të deputetëve në Bruksel dhe trajnimi i stafit të drejtorisë së zgjerimin pranë Komisionit dhe Parlamentit Europian dhe ndjekja e realizimit me sukses të këtij objektivi kombëtar.

Në datën 13 korrik 2015 Presidenti i Parlamentit Europian, z. Martin Shulc, zhvilloi një vizitë zyrtare në Tiranë, gjatë së cilës mbajti një fjalë përshëndetëse në Kuvendin e Shqipërisë.

Gjatë vitit, siç parashikon rregullorja e Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri (SAPC), janë realizuar dy takime vjetore të këtij Komiteti. Takimi i 8-të i SACP-it u mbajt në Tiranë më 15–17 mars 2015, ndërsa takimi i 9-të u mbajt në Bruksel më 8–9 nëntor 2015.

Gjithashtu gjatë vitit deputetë dhe përfaqësues të stafit të administratës së Kuvendit të Shqipërisë kanë marrë pjesë në 10 aktivitete të organizuara nga Parlamenti Europian.

Delegacionet e përhershme të Kuvendit të Shqipërisë pranë organizatave shumëpalëshe kanë marrë pjesë në sesionet parlamentare dhe takimet e komisioneve të përhershme apo në aktivitete të ndryshme të këtyre organizatave shumëpalëshe ku vendi ynë është anëtar, si: NATO, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, OSBE, IPU, SEECP, PABSEC, CEI. Po ashtu dhe në disa aktivitete të GOPAC, PUIC, Energy Community, Asambleja Parlamentare e Ortodoksisë, Unioni i Grave Parlamentare etj.

Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar 6 aktivitete në kuadër të bashkëpunimit të organizatave shumëpalëshe dhe bashkëpunimit rajonal, si më poshtë:

- 12–13 mars: takimi i kryetarëve të komisioneve të jashtme të vendeve anëtare të SEECP-së;
- 15–17 mars: takimi i 8-të i SAPC-it;
- 17–18 prill: takimi i grupit të punës të SEECP-it;
- 21–23 maj: sesioni plenar i Asamblesë Parlamentare të SEECP-së.
- 19–20 tetor: mbledhja e Komisionit për Çështjet Sociale të PABSEC-ut
- 22–24 tetor: takimi i COSAP-it;
- 3–4 dhjetor: takimi i sekretarëve të përgjithshëm të parlamenteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, 2015.

Kapitulli 6

TRANSPARENCA PARLAMENTARE


Parlamenti dhe publiku

Transparenca nuk është vetëm një parim themelor mbi të cilin duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre institucionet shtetërore në tërësi, por mbi të gjitha është një domosdoshmëri, e cila u mundëson qytetarëve të informohen, të monitorojnë, madje të kontrollojnë veprimtarinë dhe punën e institucioneve, duke i siguruar publikut një mënyrë për t'u përfshirë në procesin e vendimmarrjes. Për këtë arsye gjatë vitit 2015 i është kushtuar një vëmendje e posaçme nxitjes dhe forcimit të komunikimit me publikun.

Sa i përket trajtesës së kërkesave drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, përfshirë edhe ato për informacionin dhe dokumentacionin, evidencat dëshmojnë se qytetarët kanë marrë përgjigje orientuese, informuese si dhe këshillim ligjor për çështjet e përcjella me shkrim pranë strukturave të posaçme të këtij institucioni sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve dhe procedurave institucionale po ashtu. Shqetësimet e qytetarëve u përkasin kryesisht çështjeve që lidhen me drejtësinë, me punësimin, shërbimin e energjisë elektrike, me kthimin dhe kompensimin e pronave, me çështjen e sigurimeve etj.

Në kuadër të bashkërendimit të punës me universitetet dhe drejtoritë mësimore për zbatimin e programeve që kanë për qëllim njohjen e studentëve dhe nxënësve me veprimtarinë e Kuvendit, janë zbatuar projekte të ndryshme, edhe në bashkëpunim me OSBE-në, për organizimin dhe krijimin e urave lidhëse midis qytetarëve me Kuvendin, u është dhënë prioritet procedurave lehtësuese të pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes si dhe në pjesëmarrjen e studentëve në ambientet e ndryshme të Kuvendit të Shqipërisë, duke e bërë sa më transparente punën administrative të këtij institucioni. Gjithashtu janë organizuar takime me shoqërinë civile, studentë dhe qytetarë në Tiranë dhe në rrethe për të prezantuar mënyrat më të kuptueshme dhe më lehtësuese.

Evidencat dëshmojnë se numri i vizitorëve në Kuvendin e Shqipërisë gjatë vitit 2015 është katërfishuar në krahasim me një vit më parë.



Paraqitja grafike krahasuese e shkresave për periudhën 2014–2015



Evidenca krahasuese e shkresave sipas kategorive për periudhën 2014–2015

	<i>Muaji</i>	<i>Kartela ²</i>		<i>Kthim përgjigje</i>		<i>Fletëhyrje</i>		<i>Pritja e qytetarëve</i>	
		<i>2014</i>	<i>2015</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1	Janar	94	28	19	18	43	135	22	26
2	Shkurt	116	54	27	27	28	89	19	20
3	Mars	132	60	29	42	47	475	29	16
4	Prill	101	70	47	34	57	353	24	17
5	Maj	88	79	36	50	23	305	14	12
6	Qershor	78	54	27	40	15	132	16	35
7	Korrik	80	45	18	21	18	16	4	17
8	Gusht	23	25	17	12	0	0	0	0
9	Shtator	88	60	21	21	18	48	30	32
10	Tetor	57	54	33	26	7	58	27	29
11	Nëntor	67	61	15	23	231	166	8	42
12	Dhjetor	92	43	22	26	98	260	12	27
	Gjithsej	1016	618	311	327	585	2187	205	273

Në funksion të rritjes së transparencës ndaj publikut gjatë gjithë vitit 2015 ka vijuar me rigorozitet përditësimi i programit të transparencës i Kuvendit të Shqipërisë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës institucioni ynë ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale. Informacioni i bërë publik në këtë program synon të bëjë transparent veprimtarinë e punës së Kuvendit të Shqipërisë përmes paraqitjes së detajuar të tij dhe lehtësisht të kuptueshme në faqen zyrtare www.parlament.al si dhe në mjediset e institucionit. Ky program është ndërtuar në mënyrë të tillë që mundëson dhënien e informacionit për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Parlamenti dhe media

Parlamenti dhe media janë dy aktorë të rëndësishëm të një demokracie funksionale. Nisur nga ky përcaktim faktik, ndërtimi i marrëdhënieve të forta, cilësore dhe profesionale me medien, të bazuara në parimin e transparencës, objektivitetit dhe të paanshmërisë, është objektivi i synuar gjatë vitit 2015.

Në përmbushje të këtij synimi Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun e ka mbështetur aktivitetin e tij në pasqyrimin e axhendës së aktiviteteve parlamentare në kohë dhe me saktësi, në organizimin e punës për njoftimin, komunikimin, akreditimin dhe mbështetjen e gazetarëve, me qëllim informimin e tyre mbi veprimtaritë parlamentare. Shërbimi bashkëpunon me medien për t’iu përgjigjur kërkesave të tyre për informacion dhe dokumentacion, si dhe kërkesave të tjera të tyre ndaj strukturave parlamentare. Pavarësisht kohëzgjatjes dhe tendencës gjithnjë në rritje të punës në komisione dhe në seancë plenare, stafi i këtij Shërbimi është përpjekur që t’u përgjigjet me përkushtim kërkesave dhe të përmbushë detyrat e tij në funksion të transparencës parlamentare.

Gjatë vitit 2015 janë ndjekur dhe pasqyruar 384 mbledhje të komisioneve parlamentare dhe 46 seanca plenare, të cilat përmes njoftimeve për shtyp dhe fotove ilustruese janë pasqyruar në faqen zyrtare të Kuvendit: www.parlament.al.



2. Përfshihen shkresa falënderimi, konfirmimi, kërkesa për organizim takimesh me Kryetarin e Kuvendit dhe deputetët, peticione për komisionet.

Gjithashtu materialet e publikuara *on-line* janë përkthyer në kohë reale në gjuhën angleze dhe janë publikuar në seksionin anglisht po në faqen zyrtare të internetit.

Gjatë vitit 2015 janë akredituar rreth 300 përfaqësues të medie dhe 167 punonjës teknik.

Të dhënat e një analize krahasuese për dy vjetët e fundit (2014–2015) dëshmojnë se numri i mbledhjeve të komisioneve parlamentare dhe seancave plenare të ndjekura dhe të pasqyruara nga Shërbimi në webpage dhe të komunikuar në medie është dukshëm më i lartë se ai i vitit 2013, duke marrë parasysh edhe periudhat zgjedhore që kanë karakterizuar vitin 2013 dhe atë 2015.

Materialet informuese gjatë vitit 2015 në komisione, në seancë plenare etj.




Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Biblioteka

Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Biblioteka, si pjesë e Shërbimit të Informacionit dhe Dokumentacionit në Kuvendin e Shqipërisë, mbështet punën e deputetëve të Kuvendit dhe të stafit të tyre për përmbushjen e funksionit ligjvënës gjatë punës në komisione dhe në veprimtari të tjera parlamentare. Ky Shërbim bën kërkime legjislative dhe përgatit studime kërkimore duke u bazuar në praktikën më të mirë të vendeve perëndimore, me fokus vendet anëtare të Bashkimit Europian, si dhe në përvojat e ngjashme të vendeve të rajonit të Ballkanit. Për realizimin e tyre përdoren burime të

besueshme të informacionit që disponon Shërbimi i Kërkimit Parlamentar, si ECPRD, IPEX, EUR-Lex, IPU etj.


Studimet kërkimore gjatë vitit 2015 ndër të tjera kanë trajtuar tema rreth reformës në sistemin e drejtësisë, reformës në arsim, informalitetit dhe evazionit fiskal si dhe disa tematika sociale. Studimet kërkimore të këtij Shërbimi mbi parlamentet e tjera janë botuar në dy numra të revistës “Kuvendi”, po ashtu kanë gjetur reflektim si referenca në artikuj të tjerë për botim. Gjithashtu vlen të përmendet fakti se si rrjedhojë e vënies në zbatim të rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë, Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës ka ndërmarrë studime kërkimore (me kërkesë ose me iniciativën e vet) të një cilësie në rritje me një standard dhe strukturë të përcaktuar. Kjo për shkak se në këtë rregullore përcaktohen qartë elemente si: formulari i kërkesës, afatet për kthimin e përgjigjes, formati i materialit, protokollet e komunikimit etj. Vlerë e shtuar për këtë Shërbim është dhe stafi i tij, i cili jo vetëm është rritur në numër, por ka edhe begrund të ndryshëm akademik.

Në punën e Shërbimit ka ndikuar pozitivisht edhe mbështetja e organizatave të huaja, si NDI me anë të trajnimit të stafit, pjesëmarrjes në konferenca dhe krijimit të një baze të re të dhënave për bashkëpunimin me vendet e rajonit.




Gjatë vitit 2015 është konsoliduar bashkëpunimi me Qendrën Europiane të Kërkimit dhe Dokumentacionit Parlamentar (ECPRD).

Përmbledhje e korrespondencës së mbajtur me ECPRD:





Kërkesa drejtuar ECPRD-së për vitin 2015:





Biblioteka dhe Periodiku kryen zhvillimin dhe organizimin e vazhdueshëm të burimeve të informacionit, në mënyrë që të sigurojë dhënien sa më të saktë e të shpejtë në funksion të procesit legjislativ. Për shkak të zhvillimeve pozitive integruese të vendit në BE si dhe me marrjen e statusit të vendit kandidat, por edhe në zbatim të rekomandimeve të IPA-s, vihet re një tendencë në rritje për librin në fushën e integritimit europian dhe të institucioneve të BE-së në fusha si: jurisprudencë, politika ekonomike, politikat sociale etj. Për këtë qëllim Biblioteka e Kuvendit të Shqipërisë gjatë vitit 2015 ka pasuruar këndin e BE-së me 44 libra të rinj të huaj, botime të viteve të fundit, me përmbajtje nga legjislacioni i BE-së.

Për sa i takon numrit të lexuesve (deputetë dhe staf) gjatë vitit 2015 janë 101 lexues, të cilët e kanë frekuentuar bibliotekën 981 herë. Numri i përdoruesve nga jashtë është tri herë më i lartë se në vitin 2014.

Ky Shërbim, duke pasur si prioritet vënien në dispozicion të Bibliotekës për të shërbyer si burim informimi si dhe nxitjen e standardeve të larta të ofrimit të shërbimeve bibliotekare dhe informuese, me vendim të Byrosë së Kuvendit nr. 31 datë 21.05.2015 u anëtarësua në Federatën Ndërkombëtare të Shoqatave dhe Institucioneve Bibliotekare (IFLA), si organi kryesor ndërkombëtar që përfaqëson interesat e Bibliotekës, Shërbimit të Informacionit dhe përdoruesve të tyre, zëri global i profesionit të Bibliotekës dhe Informacionit në shërbim të gjithë punës së Kuvendit. Në këtë kuadër, Shërbimi i Periodikut pranë Bibliotekës ofron një bazë të dhënash, e cila pasurohet në mënyrë të vazhdueshme me titujt lidhur me aktivitetin parlamentar dhe deputetët. Në bazë të këtyre të dhënave hartohen listat bibliografike përkatëse.

Në funksion të transparencës parlamentare gjatë vitit 2015 janë realizuar dy numra të revistës së Kuvendit dhe janë ideuar e projektuar ribotime librash dhe botime të reja me vlerë historike dhe arkivore për Kuvendin dhe botën akademike e universitare gjithashtu.

Një element i rëndësishëm i transparencës mbi veprimtarinë parlamentare, që është njohja e publikut me dokumentet parlamentare, është realizuar përmes zbardhjes dhe redaktimit të procesverbaleve të seancave plenare, të komisioneve të përhershme, të përkohshme, të posaçme dhe hetimore parlamentare, të mbledhjeve të Këshillit të Integritimit, të Këshillit të Mandateve dhe Imuniteteve të tryezave e forumeve të reformës në drejtësi, si dhe redaktimi i mbledhjeve të konferencave të Kryetarëve, të Byrosë Parlamentare dhe të Dokumentit Analitik për Sistemin e Drejtësisë në Shqipëri.



Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit

Viti 2015 ka qenë i orientuar drejt realizimit të dy projekteve të rëndësishme për Kuvendin e Shqipërisë. Së pari, ideimi dhe implementimi i sistemit audio-video në mjediset e Kryesisë së Kuvendit të Shqipërisë. Kuvendit të Shqipërisë i është miratuar mbështetja financiare nga fondet IPA për implementimin e këtij sistemi, i cili pritet të realizohet gjatë vitit 2016.

Kuvendi i Shqipërisë ka ndërtuar dhe po kryen testimet e fundit të faqes së re të internetit, të përgatitur për bërjen publike për përdoruesit në 1 shkurt 2016.

Faqja e re *on-line* mundëson një akses më të lehtë kërkimi dhe informacioni jo vetëm për stafin e Kuvendit, por dhe për qytetarët.

Nëpërmjet kësaj faqeje janë sjell disa risi, në mënyrë që dokumentet parlamentare të jenë të lehta për t'u aksesuar. Përveç kësaj janë ngritur rubrika të veçanta, ku është bërë e mundur që qytetarët të aplikojnë direkt për të ndjekur nga afër punimet e seancave plenare dhe të komisioneve parlamentare.

Nëpërmjet kësaj faqeje Kuvendi ka bërë të mundur edhe rritjen e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në jetën parlamentare, duke i lehtësuar edhe më shumë procedurat dhe duke i bërë më të dukshëm nismat ligjore që shqyrton komisioni. Qytetarët do ta kenë më të lehtë të kontaktojnë me deputetin e



tyre, pasi në faqen kryesore ata mund të klikojnë direkt dhe t'i shkruajnë deputetit në adresën e tij personale.

Po ashtu nëpërmjet faqes së re të internetit qytetarët do të kenë mundësi të dërgojnë *on-line* kërkesat, ankesat, vërejtjet etj., gjë që rrit në mënyrë të dukshme transparencën parlamentare.

Gjatë vitit 2015 është intensifikuar puna dhe është shtuar numri i përdoruesve të platformës *E-parlament*. Po ashtu është përgatitur një faqe për përdorimin e dokumenteve të brendshme të stafit të Kuvendit (intranet), e cila do të vihet në punë gjatë tremujorit të parë të viti 2016. Kjo faqe përveç rregulloreve, dokumenteve të ndryshme që do të publikohen do të ketë edhe një opsion tjetër, që është krijuar në formë kontakti, ku të gjithë punonjësit e Kuvendit pa përjashtim mund të lidhen me Shërbimin e Teknologjisë së Informacionit për problemet që hasin gjatë punës së tyre dhe një person nga *Help Desk* do të jetë i disponueshëm, pasi kërkesat e tyre do të vijnë nëpërmjet *e-mail*-it.



Kapitulli 7

ADMINISTRIMI

Shërbimi i Financës dhe i Buxhetit

Për vitin 2015, me përgjegjësi maksimale, në Shërbimin Administrativ u organizua dhe u drejtua puna për hartimin e dokumentit të PBA-së 2016–2018 në dy fazat që parashikon kuadri ligjor në fuqi dhe iu përcoll Ministrisë së Financave brenda afatit të përcaktuar në udhëzimet buxhetore. Ky dokument u hartua në bazë të vlerësimit të nevojave të të gjitha shërbimeve të Kuvendit, me qëllim realizimin e objektivave për secilin shërbim. Dokumenti i PBA-së është shoqëruar me pasqyrat e kërkesave shitesë dhe relacionin sqarues, ku duhet theksuar se pesha specifike më e madhe në këto kërkesa u përket nevojave për organizimin e dy aktiviteteve të mëdha ndërparlamentare: Asamblesë Parlamentare e NATO-s, sesioni i pranverës, dhe Asamblesë Parlamentare të Mesdheut (PAM), që do të zhvillohen në Tiranë gjatë vitit 2016.

Në zbatim të neneve 10 dhe 11 të Rregullores së Kuvendit, projektbuxheti u është bërë me dije paraprakisht Sekretariatit të Buxhetit dhe Byrosë së Kuvendit, duke e shoqëruar me analizën dhe argumentet përkatëse.

a. Synimet kryesore të buxhetit:

- Rritja e efektivitetit në menaxhimin e shpenzimeve publike.
- Mundësimi i plotësimit të nevojave buxhetore në realizimin e politikave të programeve.
- Përfshirja e të gjithë menaxherëve të lartë të institucionit në procesin e vlerësimit të nevojave dhe në zbatimin e buxhetit.
- Orientimi i shpenzimeve në ato drejtime që vlerësohen si prioritet për politikën e programit.

b. Realizimi i buxhetit

Gjatë vitit 2015 Drejtoria e Financës dhe Buxhetit administroi dhe menaxhoi fondet publike, të ndara në dy programe buxhetore:

- Veprimtarisë legislative dhe planifikimit
- Menaxhimit dhe administrimit

Në vitin 2015, si rezultat i rivlerësimit të nevojave, janë kthyer fonde në buxhet, të cilat u reflektuan në aktin normativ nr. 3 datë 28.12.2015.




Plani buxhetor vjetor me ndryshimet e bëra gjatë vitit pasqyrohet në tabelën më poshtë.

Plani vjetor buxhetor 2015 me ndryshimet gjatë vitit (shpenz. operative)

në lekë

Kod Institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Emërtimi i projektit	Buxheti sipas ligjit 160/2014, datë 27.11.2014	Shtesa / pakësime gjatë vitit	Plani buxhetor sipas aktit normativ nr. 3, datë 28.12.2015
Programi legjislativ							
1002001	01	01120	600000	Pagat	336.000.000	48.500.000	287.500.000
1002001	01	01120	601000	Kontributi i sigurimeve shoqërore	43.000.000	-9.500.000	33.500.000
1002001	01	01120	602000	Mallra dhe shërbime	285.000.000		285.000.000
1002001	01	01120	605000	Transferta korrente të huaja	13.900.000	-3.000.000	10.900.000
					677.900.000		616.900.000
Programi Administrativ							
1002001	01	01110	600000	Pagat	188.000.000	-14.000.000	174.000.000
1002001	01	01110	601000	Kontributi i sigurimeve shoqërore	33.000.000	-5.500.000	27.500.000
1002001	01	01110	602000	Mallra dhe shërbime	117.500.000	-50.000.000	67.500.000
1002001	01	01110	605000	Transferta korrente të huaja	0		
					338.500.000		269.000.000
					1.016.400.000	130500000	885.900.000


Pesha specifike e secilës llogari ekonomike mbi totalin paraqitet sipas grafikut:





Zëri i pagave (llogaria ekonomike 600) është realizuar 88% kundrejt planit buxhetor fillestar.

Fondi i pagave përbëhet nga fondi i pagave për deputetët, fondi i pagave për stafin politik dhe stafin administrativ mbështetës. Realizimi faktik i fondit të pagave për secilin program paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Në listëpagesat e pagave janë ndaluar me korrektësi kontributet e punëmarrësve për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe ato suplementare si dhe tatimi mbi të ardhurat nga paga sipas legjislacionit në fuqi.

Transferimi i pagave në llogaritë bankare për punonjësit dhe deputetët bëhet në 11 banka të nivelit të dytë. Njoftimet për kreditimin në llogari bëhen nëpërmjet adresave elektronike të punonjësve dhe deputetëve.

Shkaqet e mosrealizimit 100% të fondit të pagave dhe kthimit në buxhet janë:

- Në ligjin vjetor të buxhetit janë miratuar 24 punonjës për zyrat zgjedhore në rrethe, por vetëm 7 prej tyre kanë filluar marrëdhëniet financiare me Kuvendin për shkak të mosvënies në dispozicion të ambienteve nga autoritetet vendore në shumë rrethe.
- Një pjesë e pozicioneve nuk janë plotësuar, janë në proces konkurrimi.
- Vendimi i Kuvendit nr. 114/2014 penalizon deputetët që nuk marrin pjesë në aktivitete parlamentare (seanca plenare dhe komisione të përhershme parlamentare) me vlerën e pagës ditore kur mospjesëmarrja nuk ka shkaqe të ligjshme.
- Gjatë vitit buxhetor punonjësit e paafte për punë për shkaqe shëndetësore apo leje lindjeje paguhen nga strukturat e sigurimeve shoqërore.

Shpenzimet për sigurimet shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Fondi i akorduar për vitin 2015 ishte 76 milionë lekë, ndërsa realizimi faktik është 61 milionë lekë, pra 80%.

Duke qenë se fondi i sigurimit është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, shkaqet e mosrealizimit të fondit të pagave vlejné dhe për këtë zë, por duhet të theksojmë se gjatë vitit ushtrimor shumë punonjës rast pas rasti paguhen për aftësi të përkohshme në punë dhe për këtë periudhë nuk paguhen kontribute. Shërbimi i Financës ka deklaruar *on-line* në sistemin tatimor kontributet për secilin punonjës dhe deputet, duke referuar numrin e sigurimit shoqëror për secilin, si dhe ka transferuar pagesat e këtyre kontributeve, duke respektuar afatet ligjore.




Gjithashtu shtesat dhe pakësimet në numrin e punonjësve kanë ndjekur udhëzimet në lidhje me kohën e regjistrimit apo atë të çregjistrimit të punonjësit.

Shpenzimet operative (Ilogaria ekonomike 602)

Ky zë përfshin një gamë të gjerë shërbimesh të domosdoshme për mirëfunksionimin e institucionit dhe realizimin e objektivave të të gjitha shërbimeve. Gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2015 Shërbimi i Financës ka zbatuar udhëzimin nr. 2.01.2015. Çdo urdhër prokurimi është dërguar në degën e thesarit për miratim përpara ekzekutimit, sikundër çdo kontratë e nënshkruar me të tretë është regjistruar në buxhet për të ngurtësuar angazhimet në vlerën e saj, me qëllim moslejimin e ndërrimit të destinacionit të fondeve dhe krijimin e debitorëve.

Gjithashtu Shërbimi i Financës ka ndjekur dhe kontribuar në hartimin e gjurmëve të auditimit, duke iu përgjigjur urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave lidhur me procedurat për blerjet me vlerë të vogël dhe të lartë të prokurimeve. Ky zë në total është realizuar në masën 87,6%.

Trendi i disa grupeve të shpenzimeve për tre vjetët e fundit paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Përfitimet financiare që marrin deputetët varen nga deklaratat që ata bëjnë për ditët e shërbimeve brenda vendit si dhe nga numri faktik i mbledhjeve të komisioneve gjatë vitit. Referuar grafikut, shihet se këto përfitime janë në rritje. Shpjegimi është se në vitin 2013, i cili ka qenë vit elektoral, nuk janë marrë përfitime për periudhën e fushatës e deri në fillimin e legjislaturës së re, pra ka më pak shpenzime të tilla. Në vitin 2014 dhe vitin 2015 deputetët që kanë kaluar në qeveri (në funksionin e ministrit) kanë dorëzuar mandatin dhe janë zëvendësuar me deputetë të rinj. Si rrjedhojë, nga 126 deputetë që ishin deri më 2013, tashmë janë 140 deputetë.

Duhet theksuar se në vitin 2014 dhe 2015 dietat brenda vendit u paguan mbi bazën e vetëdeklarimit të deputetëve, që në disa raste rezultojnë më pak se e drejta e përfitimit (ndryshe nga periudha deri në vitin 2013, kur paguheshin në mënyrë taksative nga 6 apo 12 ditë, sipas vendbanimit).

Shpenzimet telefonike kanë pësuar rënie të ndjeshme, pasi, ndërsa telefonja fikse është konsumuar në mënyrë të kontrolluar e mirëmenaxhuar, telefonja celulare nuk ka pasur kontratë, kështu që nga buxheti i shtetit nuk është paguar telefoni mobile për përfituesit. Për telefoninë janë planifikuar 11,4 milionë lekë dhe janë shpenzuar 3 milionë lekë.



Shpenzimet e energjisë, të ujit dhe shërbimit postar gjithashtu paraqiten me rënie (nga 13 milionë të planifikuara janë realizuar 8,5 milionë).

Shpenzimet e pritjes janë në rritje për shkak të numrit të delegacioneve të huaja në vendin tonë, për të cilat janë respektuar kuotat e ushqimit sipas kuadrit ligjor në fuqi, megjithëse i pandryshuar për shumë e shumë vjet.

Investimet kapitale

Me ligjin e buxhetit vjetor 2015 ishin miratuar këto projekte investimi:

Në lekë:

Institucioni	Kap.	Programi	Debiti	Emërtimi i projektit
Shuma			98.800.000	
Kuvendi i Shqipërisë	01	01110	53.800.000	Rikonstruksion i fasadës, tarracës dhe ambienteve të tualetit
Kuvendi i Shqipërisë	01	01110	25.000.000	Sistemi i sigurisë me kamera CCTV
Kuvendi i Shqipërisë	01	01110	5.000.000	Blerje pajisjesh elektronike, zyra zgjedhore etj.
Kuvendi i Shqipërisë	01	01110	7.000.000	Pajisje zyrash, salla VIP plenare dhe të Kryesisë
Kuvendi i Shqipërisë	01	01110	6.000.000	Ashensor
Kuvendi i Shqipërisë	01	01110	2.000.000	Fondi i librit

Tabela e investimeve të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2015

Në muajin maj 2015, pas vizitës së Presidentit të Turqisë dhe deklaratave të tij për financimin e kompleksit të ri parlamentar, ndryshoi vendimmarrja dhe me miratimin e ministrive përkatëse buxheti për shpenzimet kapitale 2015 u bë:

Tabela e investimeve të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2015

Në lekë		
Institucioni	Debiti	Emërtimi i projektit
Shuma	67.220.000	
Kuvendi i Shqipërisë	4.520.000	Optimizimi i rrjetit (pjesor, nga viti 2014)
Kuvendi i Shqipërisë	7.000.000	Rikonstruksion pjesor i godinës ekzistuese (tarraca)
Kuvendi i Shqipërisë	1.200.000	Rikonstruksion pjesor i Sallës së Seancave
Kuvendi i Shqipërisë	1.500.000	Rikonstruksion i skanerit të sigurisë
Kuvendi i Shqipërisë	1.200.000	Rikonstruksion i ashensorit ekzistues
Kuvendi i Shqipërisë	0	Sistem ndriçimi i fasadës së godinës së Kryesisë
Kuvendi i Shqipërisë	25.000.000	Sistemi i sigurisë me kamera CCTV
Kuvendi i Shqipërisë	6.740.000	Blerje pajisjesh elektronike, zyra zgjedhore etj.
Kuvendi i Shqipërisë	10.300.000	Mobilim zyrash, salla VIP te Salla Plenare dhe Kryesia
Kuvendi i Shqipërisë	6.000.000	Ashensor
Kuvendi i Shqipërisë	960.000	Fondi i librit
Kuvendi i Shqipërisë	600.000	Rikonstruksion i sistemit ftohës në sallën e serverave
Kuvendi i Shqipërisë	1.200.000	Projekt për rikonstruksionin e Sallës së Seancave
Kuvendi i Shqipërisë	1.000.000	Projekt për rikonstruksionin e godinës ekzistuese të Kryesisë



Shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 92%, ndërsa si projekt vetëm projekti për rikonstruksionin e Sallës së Seancave Plenare nuk është realizuar.

Pjesa tjetër janë kursime nga procedurat e prokurimit dhe do të kthehen në buxhetin e shtetit.

Projektet e investimeve janë marrë në dorëzim nga grupet e punës, të cilët kanë verifikuar përputhshmërinë me specifikimet e kërkuara, sasinë, cilësinë etj.

Në pagesat e faturave është mbajtur 5% për garanci cilësie. Kjo vlerë është transferuar në llogarinë e buxhetit të shtetit “mjete monetare në ruajtje”.

Gjatë vitit 2015, pas raportit përfundimtar të marrjes në dorëzim të investimeve, u paguan këto garanci për dy lote të sistemit “E-parlament”, investim i vitit 2013 dhe garancia për pajisjet e zyrave zgjedhore dhe blerjen e kondicionerëve, investime të vitit 2014.

Menaxhimi i aktiveve në institucion

Shërbimi i Financës, në zbatim të ligjit për kontabilitetin, ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit nr. 30 të ministrit të Financave, datë 27.12.2011, ka iniciuar fillimin e procesit të inventarizimit të aktiveve në përdorim të punonjësve dhe të materialeve në magazina, për të vazhduar më pas me procesin e vlerësimit të aktiveve që vlerësohen jashtë funksionit e përdorimit dhe tjetërsimin e tyre (nxjerrjen jashtë përdorimit).

Gjatë vitit 2015 është ndjekur me korrektësi procesi i transferimeve kapitale të kompjuterave që u hoqën nga përdorimi në kuadër të strategjisë së pajisjes së gjithë stafit të Kuvendit me kompjutera të rinj, me qëllim përdorimin e sistemit “E-parlament” dhe menaxhimin e tyre më me lehtësi.

Për të gjitha entitetet buxhetore është hartuar dokumentacion i rregullt.

Gjithashtu është bërë shpërndarja e laptopëve deputetëve.

Po ashtu është ndjekur pajisja e zyrave zgjedhore dhe krijimi i kartelave të marrjes në dorëzim nga punonjësit e këtyre zyrave në rrethe.

Shërbimi i Prokurimeve

Menjëherë pas miratimit të buxhetit të shtetit për vitin 2015, në zbatim të rregullave të prokurimit publik, bazuar në legjislacionin në fuqi, Shërbimi i Prokurimeve, pasi u konsultua dhe me shërbimet e tjera të Kuvendit, përgatiti regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për vitin 2015. Ky regjistër u dërgua për botim në Agjencinë e Prokurimit Publik sipas afateve të përcaktuara në legjislacion. Nga një kopje iu dërgua Ministrisë së Financave dhe Degës së Thesarit.

Pas botimit të regjistrit të parashikimeve nga Agjencia e Prokurimit Publik, Shërbimi i Prokurimeve, në bashkëpunim me drejtoritë e linjës, filloi punën për plotësimin e dokumentacionit për shpalljen e procedurave. Një kopje e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike u publikua edhe në faqen e internetit të Kuvendit të Shqipërisë.

Të gjitha procedurat standarde të prokurimit u zhvilluan me mjete elektronike nëpërmjet sistemit *on-line* të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Gjatë vitit 2015 në Kuvendin e Shqipërisë janë shpallur gjithsej 28 procedura prokurimi me blerje të mëdha dhe 48 procedura me blerje të vogla. Blerja e biletave të transportit jashtë vendit është kryer me procedurë me blerje të vogël. Gjithsej janë bërë rreth 200 procedura nga komisioni i blerjeve të vogla derisa Shërbimi i Prokurimit realizoi procedurën e marrëveshjes kuadër për biletat e transportit ndërkombëtar. Kjo marrëveshje u lidh me dy operatorë ekonomikë më 3 dhjetor dhe efekti i saj shtrihet deri më 31.12.2016.

• Fondi limit i parashikuar për këto procedura ka qenë 159,743,862 lekë (pa TVSH), nga të cilat 121,582,701 lekë ishin fonde investimesh dhe 38,161,161 lekë ishin procedura me fondet e shpenzimeve operative.



- Me fondet e investimeve u realizuan 17 procedura prokurimi, nga të cilat 8 procedura me blerje të mëdha dhe 9 procedura me blerje të vogla.
- Me fondet e shpenzimeve operative u realizuan 51 procedura prokurimi, nga të cilat 20 janë procedura me blerje të mëdha dhe 31 janë procedura me blerje të vogla, pa llogaritur procedurën e blerjes së biletave të transportit ajror.
- Si rezultat i konkurrencës, u arrit që në përfundim të procedurave të kishte një efekt ekonomik pozitiv ndaj fondit limit.
- Të gjitha procedurat e prokurimit të planifikuara për vitin 2015 përfunduan brenda afatit të përcaktuar në rregullat e prokurimit, pra para datës 31 dhjetor.

Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe i Trajtimit të Deputetëve

Në mbështetje të legjislacionit për marrëdhëniet e punës dhe të procedurave të pranimit e në plotësim të vendeve të reja të punës, në disa pozicione të Shërbimit Civil të krijuara nga miratimi i strukturës së administratës së Kuvendit me vendimin nr. 2, datë 08.11.2013 të Byrosë së Kuvendit dhe vendimeve të mëvonshme të saj për përmirësimin dhe fuqizimin e strukturës, si dhe “Planit të pranimeve të reja në Shërbimin Civil të Kuvendit”, miratuar me vendimin nr. 5, datë 25.02.2015, Shërbimi i Burimeve Njerëzore ka punuar për plotësimin e organikës së administratës së Kuvendit.

Për periudhën janar–dhjetor 2015 në administratën e Kuvendit janë punësuar gjithsej 43 nëpunës, nga të cilët: 18 nëpunës politikë, 21 në pozicione të Shërbimit Civil (3 të nivelit drejtues, 18 specialistë) dhe 4 nëpunës të thjeshtë.

Plotësimi i vendeve të lira është bërë nëpërmjet emërimeve të përkohshme për disa pozicione emergjente (11) gjatë periudhës shkurt–tetor 2015.

Mbështetur në ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2104”, gjatë periudhës janar–dhjetor 2015 janë zhvilluar 25 konkurse pranimi në Shërbimin Civil për pozicione nga specialist deri drejtor drejtorie, nëpërmjet të cilave u rekrutuan 20 nëpunës si më poshtë:

- 11 rekrutime të reja në nivelin ekzekutiv;
- 3 me lëvizje paralele nga jashtë institucionit;
- 2 lëvizje paralele brenda institucionit;
- 4 me ngritje në detyrë brenda institucionit.

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” dhe gjithë kuadrit ligjor u krye konfirmimi dhe deklarimi si më poshtë:

1. Konfirmimi si nëpunës civil nga eprori direkt për 49 nëpunës dhe akti i deklarimit të statusit të nëpunësit civil nga njësia përgjegjëse (Drejtoria e Burimeve Njerëzore) për këta 49 nëpunës (26.02.2015).

2. Gjatë vitit 2015 kanë mbyllur periudhën e provës 10 nëpunës të rekrutuar në Shërbimin Civil sipas ligjit të ri. Për ata është bërë konfirmimi i statusit të nëpunësit civil nga eprori direkt dhe akti i deklarimit të statusit nga Shërbimi i Burimeve Njerëzore dhe i Trajtimit të Deputetëve.

3. Gjatë vitit 2015–2016 janë në periudhë prove 16 nëpunës.

Në zbatim të strategjisë së trajnimit për stafin e administratës së Kuvendit janë kryer trajnime të shumta, si: “Shkrimi efektiv”, ku u trajnuan 46 nëpunës civilë; “Teknikat legjislative”, ku u trajnuan 47 nëpunës; “Trajnimi i trajnerëve”, financuar nga OSBE-ja, ku u certifikuan 16 nëpunës.

Po ashtu në drejtim të rritjes së kapaciteteve të administratës së Kuvendit gjatë vitit 2014 kanë kryer trajnime të detyruar “Prezantimi me administratën publike” pranë ASPA-s i 47 nëpunësve civilë të nivelit ekzekutiv. Vlerësimi ka qenë pozitiv. Ky trajnim është një nga dy kushtet për marrjen e statusit të nëpunësit civil (tjetri është vlerësimi pozitiv i periudhës njëvjeçare të provës).



Për rritjen e kapaciteteve për ekspertizë ligjore gjatë vitit 2015 kanë marrë pjesë në trajnime jashtë vendit disa drejtorë, këshilltarë të fushave të ndryshme dhe specialistë për njohjen me praktikën parlamentare të BE-së.

Bazuar në vendimin e Byrosë së Kuvendit nr. 19, datë 11.11.2014 “Për hapjen e zyrave për deputetët në 12 qarqe” dhe në bashkëpunim me prefekturat u bënë funksionale 8 zyra dhe janë emëruar specialistët e zyrave të deputetëve në rrethet si më poshtë:

- 2 specialistë në zyrat e Gjirokastrës;
- 2 specialistë në zyrat e Kukësit;
- 2 specialistë në zyrat e Fierit;
- 2 specialistë në zyrat e Korçës.

Për deputetët që kanë marrë mandatin pas dorëheqjes së deputetëve që kandiduan për zgjedhjet vendore në datën 21.05.2015, Sektori i Trajtimit të Deputetëve dhe përfaqësues të shërbimeve të tjera organizuan një takim në ambientet e Kryesisë së Kuvendit me temë “Orientim për deputetët”, me qëllim prezantimin e veprimtarive kryesore të shërbimeve të Kuvendit në funksion të deputetëve. Ky takim është mbështetur dhe nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Shërbimi i Protokollit dhe i Arkivit

Gjatë vitit kalendarik 2015 Sektori i Protokollit dhe i Arkivit në bashkëpunim kanë përmbushur objektivat, bazuar në detyrat e përcaktuara në “Manualin e përshkrimit të punës të shërbimeve të Kuvendit” si dhe në përputhje me rregulloren “Për administrimin e dokumentacionit parlamentar dhe funksionimin e Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar”.

Kështu, janë protokolluar 4124 praktika shkresore (pa fraksione) dhe një numër shumë i madh procedurash për blerjet me vlerë të madhe dhe të vogël. Në kuadër të dixhitalizimit janë regjistruar një numër i madh projektligjesh të ardhura nga Këshilli i Ministrave.

Sektori i Arkivit ka mbledhur, përpunuar dhe administruar dokumentacionin parlamentar dhe administrativ për vitet 2014 dhe 2015.

Krahas verifikimit dhe marrjes përfundimtare në dorëzim nga Zyra e Protokollit (qershor 2015) të të gjithë dokumentacionit të krijuar gjatë veprimtarisë parlamentare dhe administrative të Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2014, Zyra e Arkivit realizoi fillimisht ndarjen përfundimtare të fondit të përhershëm dhe të përkohshëm të vitit në fjalë. Më pas u kalua në përpunimin e fondit me afat ruajtjeje të përhershëm, duke automatizuar dhe ngritur inventarin përkatës:

Inventar i përhershëm 24/2014: 767 dosje (njësi vëllimore).

Inventar i përkohshëm 24/2014: në proces.

Me qëllim riformatimin dhe rishikimin e fondit arkivor në vite, ka vijuar puna në retrospektivë për fondet e atyre viteve që kërkojnë bërjen e shtesave brenda inventarëve të tyre përkatës, duke riklasifikuar dosjet ekzistuese dhe ato të reja dhe duke i unifikuar ato me bazën e përgjithshme të të dhënave të fondit arkivor të Kuvendit.

Inventar i përhershëm 1/1991 – 248 dosje

Inventar i përhershëm 2/1992 – në proces

Inventar i përhershëm 5/1995 – 389 dosje

Inventar i përhershëm 19/2009 – 536 dosje

Inventar i përhershëm 20/2010 – 613 dosje

Inventar i përhershëm 21/2011 – 552 dosje



Ka vijuar puna për dorëzimin korrent të dokumentacionit parlamentar për vitin 2015. Për periudhën janar–dhjetor 2015 janë marrë në dorëzim dhe përpunuar fizikisht rreth 325 dosje me afat të përhershëm, dokumentacion ky që u përket akteve të miratuara në seancat plenare të vitit në fjalë.

Në kuadër të inventarizimit dhe arkivimit të letrave të popullit për vitet 1991–2012 është përpunuar dhe klasifikuar fondi arkivor i letrave të popullit për vitet 1991–1997, nga ku rezultojnë 426 dosje të përfunduara.

Spektori i Arkivit ka bërë dorëzimin e dokumenteve të klasifikuara për regjistrim te zyra e Kuvendit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”. Spektori i Arkivit përpunoi dokumentacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” për periudhën 1991–2013, i cili ishte i paregjistruar në Regjistrin e Korrespondencës së Informacionit të Klasifikuar.

Në kuadër të zbatimit të vendimit të Byrosë së Kuvendit nr. 48, datë 07.12.2015, me të cilin u miratua rregullorja e re “Për funksionimin e Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar”, spektori i Arkivit u angazhua plotësisht për një përpilim më të drejtë e më të plotë të standardeve ligjore për organizimin dhe funksionimin e Arkivit të Dokumentacionit Parlamentar, duke propozuar dhe parashikuar rregulla të qarta dhe afate konkrete për të gjitha shërbimet e Kuvendit për depozitimin në Arkiv të dokumentacionit parlamentar dhe administrativ.

Spektori i Arkivit realizoi marrjen në dorëzim të fondit arkivor të Autoritetit të Konkurrencës me afat ruajtjeje të përhershëm për vitin 2004, shoqëruar me inventarin përkatës.

Bazuar në kriteret themelore të ekspertizës së vlerës së ruajtjes të përcaktuara në udhëzimet metodike përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, Spektori i Arkivit ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për hartimin e skemës së ekspertizës dhe klasifikimit të dokumenteve në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo skemë do të shërbejë për përgatitjen e listës konkrete të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare dhe të dokumenteve me afat ruajtjeje të përkohshme, duke përcaktuar edhe afatet e ruajtjes për këto të fundit.



Përfundime

Nga raportimi vjetor i punës së Kuvendit të Shqipërisë rezulton se janë hedhur hapa të rëndësishëm në drejtim të forcimit të funksionit ligjvënës të Kuvendit, të rolit mbikëqyrës së tij, po ashtu dhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit dhe të monitorimit të institucioneve të pavarura.

Është vepruar me efikasitet për shqyrtimin e përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, me qëllim garantimin e një përafrimi më efektiv dhe cilësi më të mirë. Po ashtu një punë e mirë është bërë në drejtim të forcimit të rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit me institucionet e pavarura për garantimin e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së tyre

Me synim rritjen e perceptimit të publikut për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin si dhe për një institucion plotësisht të hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm mbi rolin dhe veprimtarinë e tij në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit, Kuvendi i Shqipërisë ka realizuar një sërë veprimtarish dhe vendimmarrjesh të rëndësishme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2015 një vëmendje e veçantë iu kushtua zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe të ekspertizës në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, garantimin e transparencës parlamentare si dhe me procesin e integritetit evropian.

Bazuar në gjithë sa është parashtruar në raport, rezulton se:

a) Hapa të rëndësishëm janë hedhur në drejtim të forcimit të funksionit ligjvënës të Kuvendit, të rolit mbikëqyrës së tij, si dhe në drejtim të forcimit të bashkëpunimit dhe monitorimit të institucioneve të pavarura.

b) Është vepruar me efikasitet me qëllim forcimin e shqyrtimit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, me qëllim garantimin e një përafrimi më efektiv dhe cilësi më të mirë të legjislacionit të përafruar.

c) Ka pasur progres në forcimin e rolit mbikëqyrës dhe të ndërveprimit të Kuvendit me institucionet e pavarura, me qëllim garantimin e pavarësisë, efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së tyre

d) Janë ndërmarrë hapa dhe nisma të rëndësishme në përputhje me legjislacionin në fuqi, me synim rritjen e perceptimit të publikut për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin, si dhe rritjen e perceptimit publik për Kuvendin si një institucion plotësisht i hapur dhe transparent, i cili ofron informacionin e nevojshëm mbi rolin dhe veprimtarinë e tij në proceset zhvilluese dhe integruese të vendit.

e) Një vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit dhe forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe të ekspertizës në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me forcimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, garantimin e transparencës parlamentare dhe me procesin e integritetit evropian.



Dinamika e zhvillimeve dhe mbarëvajtjes së proceseve të punës në Kuvendin e Shqipërisë gjatë vitit 2015 ravijëzoi qartazi edhe disa nga sfidat për vitin 2016 për të pasur të gjitha standardet që kërkojnë gjithnjë e më tepër për garantimin e funksionit ligjvënës të Kuvendit të Shqipërisë në përputhje me Kushtetutën dhe me aktet ndërkombëtare. Në këtë kontekst, sfidat më të rëndësishme gjatë vitit 2016 janë:

a) Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të Kuvendit në respekt të parimeve të paanshmërisë dhe profesionalizmit të tyre.

b) Rritja e kapaciteteve të Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Integritit në funksion të rolit që ka Kuvendi për procesin e integritit në BE, si dhe për t'iu përgjigjur me shërbim cilësor hapjes së negociatave.

c) Përmirësimi i procedurave parlamentare për ligjet që synojnë përputhshmërinë me *acquis communautaire* të BE-së, të cilat janë detyrim në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

d) Vendosja e një mekanizmi efektiv për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe të pavarura në zbatim të rekomandimeve të raportit të progresit të BE-së për Shqipërinë për vitin 2015.

e) Vënia në funksionim të plotë e platformës “*E-parlament*”, duke e parë jo vetëm si zhvillimi i teknologjisë së informacionit në mbështetje të procesit legjislativ dhe transparencës parlamentare, por si një domosdoshmëri për rritjen e cilësisë dhe të funksionimit të punës së shërbimeve të Kuvendit.

f) Përmirësimi i vazhdueshëm i transparencës parlamentare përmes kërimit të mjeteve të reja. Zbatimi i sistemit të ri audio-video në Kuvend, i financuar nga fondet IPA 2014.

g) Menaxhimi dhe administrimi i fondeve dhe burimeve njerëzore në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, me synimin e vetëm për të qenë një administratë e përgjegjshme dhe efiçente në përdorimin e fondeve publike.

